Nga pikëpamja shkencore, ky studim pasuron literaturën ekzistuese duke ofruar të dhëna empirike të bazuara në një dizajn eksperimental të kontrolluar, në një kontekst ku mungojnë studime të tilla, veçanërisht në Shqipëri. Përfshirja e analizave pre–post, e ndërveprimit Time × Group dhe e diferencimit gjinor kontribuon në një kuptim më të thelluar të mekanizmave të adaptimit fiziologjik ndaj ndërhyrjeve stërvitore. Studimi vlerëson jo vetëm indikatorë antropometrikë, por edhe parametra funksionale dhe neuromuskulare, duke e zgjeruar perspektivën tradicionale të matjes së efekteve të aktivitetit fizik.

Nga pikëpamja metodologjike, rëndësia e këtij studimi qëndron në përdorimin e një protokollit të strukturuar stërvitor, të dizajnuar mbi parime shkencore të progresivitetit dhe specifikës, si dhe në aplikimin e instrumenteve të standardizuara të matjes funksionale. Kjo qasje rrit vlefshmërinë dhe besueshmërinë e rezultateve dhe krijon një model të riprodhueshëm kërkimor për studime të ardhshme në fushën e aktivitetit fizik dhe shëndetit.

Nga pikëpamja praktike dhe profesionale, gjetjet e këtij studimi ofrojnë evidencë konkrete për instruktorët e fitnesit, trajnerët personalë dhe profesionistët e shëndetit, duke demonstruar se programet e strukturuar dhe të monitoruara janë më efektive sesa stërvitja tradicionale, veçanërisht në përmirësimin e fitnesit funksional dhe kontrollit postural. Rezultatet mund të përdoren për të optimizuar programet e stërvitjes për adultët mbi 40 vjeç, duke i bërë ato më të sigurta, më efikase dhe më të përshtatura sipas nevojave individuale dhe gjinore.

Nga pikëpamja shoqërore dhe e shëndetit publik, studimi ka rëndësi të veçantë në kontekstin e plakjes progresive të popullsisë dhe rritjes së sedentarizmit. Evidencat e paraqitura mbështesin nevojën për promovimin e aktivitetit fizik të strukturuar si strategji parandaluese për reduktimin e rrezikut të sëmundjeve kronike, përmirësimin e pavarësisë funksionale dhe uljen e kostove shëndetësore afatgjata. Në këtë mënyrë, studimi kontribuon në orientimin e politikave dhe programeve të promovimit të shëndetit në nivel komunitar dhe institucional.

Së fundi, rëndësia akademike dhe formuese e këtij studimi qëndron në faktin se ai krijon një bazë të qëndrueshme për kërkime të mëtejshme shkencore, duke nxitur studime longitudinale, ndërhyrje më afatgjata dhe analiza më të detajuara të faktorëve gjinorë dhe socio-kulturorë që ndikojnë në

përgjigjen ndaj aktivitetit fizik. Ky punim synon të shërbejë si referencë për studiues, studentë dhe profesionistë të fushës së shkencave të aktivitetit fizik dhe shëndetit.

Kreu II- Diskutimi teorik

2.1 Aktiviteti fizik i strukturuar dhe tranzicioni i stilit të jetesës moderne

Shoqëritë moderne po përballen me një tranzicion të thellë të stilit të jetesës, i karakterizuar nga ulja e ndjeshme e aktivitetit fizik ditor dhe rritja e kohës sedentare. Ky fenomen është veçanërisht i theksuar në mjediset urbane dhe në vendet në zhvillim, ku teknologjia, transporti pasiv dhe natyra sedentare e punës kanë reduktuar ndjeshëm lëvizjen spontane (Hallal et al., 2012). Si pasojë, aktiviteti fizik i strukturuar, veçanërisht ai i realizuar në palestra fitnesi, është shndërruar në një komponent kyç të ruajtjes së shëndetit dhe funksionalitetit fizik. Literatura sugjeron se palestrat e fitnesit nuk përfaqësojnë thjesht hapësira stërvitore, por institucione sociale ku ndërthuren praktikatat e shëndetit, normat kulturore, identiteti trupor dhe marrëdhëniet sociale (Sassatelli, 2010). Kjo e bën pjesëmarrjen në fitnes një fenomen kompleks, që shkon përtej dimensionit biologjik të ushtrimit. Teoria e Vetëvendosjes (Self-Determination Theory – SDT) ofron një kornizë të rëndësishme teorike për të kuptuar motivimin dhe vazhdimësinë në aktivitetin fizik. Sipas kësaj teorie, motivimi i brendshëm i bazuar në kënaqësi, autonomi dhe kompetencë lidhet drejtpërdrejt me pjesëmarrje më të qëndrueshme në palestra fitnesi (Deci & Ryan, 2000; Teixeira et al., 2012). Studimet tregojnë se individët që ndihen të mbështetur nga instruktorët dhe mjedisi social i palestrës raportojnë nivele më të larta të përkushtimit dhe rezultate më të mira shëndetësore. Nga këndvështrimi sociologjik, trupi shihet si një formë kapitali social dhe simbolik. Bourdieu (1984) argumenton se investimi në trup përmes aktivitetit fizik dhe fitnesit shërben si mjet për përmirësimin e statusit social dhe vetë perceptimit. Në këtë kontekst, palestrat fitnesi bëhen arena ku ndërtohet dhe ekspozohet identiteti trupor, veçanërisht në shoqëritë moderne ku pamja fizike ka një vlerë të lartë sociale.

2.2 Përfitimet fiziologjike të pjesëmarrjes në palestra fitnesi

Ushtrimet aerobike të realizuara në palestra fitnesi (vrap, biçikletë stacionare, eliptikë, HIIT) kanë treguar përmirësime të qëndrueshme në funksionin kardiovaskular, duke përfshirë uljen e presionit arterial sistolik dhe diastolik, rritjen e kapacitetit aerob dhe përmirësimin e elasticitetit vaskular (Warburton et al., 2006). Këto efekte janë të rëndësishme jo vetëm për parandalimin, por edhe për menaxhimin e sëmundjeve kronike kardiovaskulare. Stërvitja rezistive në palestra kontribuon ndjeshëm në rritjen e forcës muskulore, stabilitetit artikular dhe densitetit mineral kockor. Këto përfitime janë veçanërisht të rëndësishme për parandalimin e osteoporozës, sarkopenisë dhe dëmtimeve muskuloskeletore, sidomos në popullatën mbi 40 vjeç (ACSM, 2021; Peterson et al., 2010).

Literatura tregon qartë se aktiviteti fizik i strukturuar ndikon pozitivisht në shëndetin mendor përmes mekanizmave neurobiologjikë dhe psikosocialë. Ushtrimet rrisin sekretimin e endorfinave,

serotoninës dhe dopaminës, duke reduktuar simptomat e depresionit dhe ankthit (Craft & Perna, 2004). Për më tepër, struktura rutinore e palestrës ndihmon në rregullimin e ritmeve biologjike dhe menaxhimin e stresit. Studime longitudinale kanë treguar se individët që ndjekin rregullisht palestra fitnesi shfaqin nivele më të ulëta të stresit kronik dhe përmirësim të vetëvlerësimit, veçanërisht tek gratë dhe të rinjtë (Fox, 1999; Rebar et al., 2015). Çështjet gjinore përbëjnë një aspekt të rëndësishëm të rishikimit të literaturës. Studimet tregojnë se motivet, barrierat dhe përvojat e pjesëmarrjes në palestra ndryshojnë ndjeshëm midis burrave dhe grave. Gratë shpesh përballen me barriera psikologjike, kulturore dhe sociale, përfshirë stereotipet gjinore dhe ndjenjën e pasigurisë në mjediset e palestrës (Markula, 2003). Megjithatë, programet e dizajnuara posaçërisht për gratë kanë treguar rritje të ndjeshme të pjesëmarrjes dhe përfitimeve shëndetësore, duke theksuar rëndësinë e qasjes gjithëpërfshirëse dhe sensitive ndaj gjinisë (Eime et al., 2015).

Pjesëmarrja në palestra fitnesi ndikohet ndjeshëm nga faktorët socio-ekonomikë, përfshirë të ardhurat, arsimin dhe vendbanimin. Studimet sugjerojnë se individët me status socio-ekonomik më të lartë kanë më shumë akses në palestra dhe programe cilësore fitnesi (Beenackers et al., 2012). Kjo krijon një hendek shëndetësor midis grupeve të ndryshme sociale. Nga perspektiva e politikave publike, kjo çështje nënvizon nevojën për ndërhyrje që rrisin aksesin në aktivitete fitnesi për grupet vulnerabël, përfshirë subvencionet, programet komunitare dhe partneritetet publike-private.

2.3 Roli i palestrave fitnesi në politikat e shëndetit publik

Organizata Botërore e Shëndetësisë e konsideron aktivitetin fizik një nga ndërhyrjet më kostoeftive për përmirësimin e shëndetit të popullatës (WHO, 2018). Palestrat fitnesi mund të shërbejnë si qendra lokale për promovimin e shëndetit, edukimin shëndetësor dhe ndryshimin e sjelljeve. Studimet sugjerojnë se integrimi i palestrave fitnesi në strategjitë kombëtare të shëndetit publik rrit efektivitetin e ndërhyrjeve parandaluese dhe redukton barrën ekonomike të sëmundjeve kronike (Pedersen & Saltin, 2015). Megjithëse literatura ndërkombëtare është e pasur, vërehet mungesë e studimeve empirike në kontekstin e vendeve të Ballkanit dhe Evropës Juglindore. Ekziston gjithashtu nevoja për më shumë studime longitudinale që analizojnë efektet afatgjata të pjesëmarrjes në palestra fitnesi, si dhe ndërveprimin midis faktorëve biologjikë, psikologjikë dhe socialë.

2.4 Efektet e ushtrimit në palestër te personat mbi 40 vjeç

Pas moshës 40 vjeç, shumë individë përjetojnë ndryshime graduale fiziologjike që ndikojnë në shëndetin dhe funksionimin ditor: ulje të masës muskulore dhe forcës (fillimet e sarkopenisë), rritje të masës dhjamore, rënie të kapacitetit aerob, reduktim të densitetit mineral kockor dhe rritje të riskut për hipertension, dislipidemi dhe çrregullime metabolike. Për këtë arsye, ushtrimi i strukturuar në palestër (kombinim i stërvitjes së forcës + aktivitetit aerobik) konsiderohet ndër

ndërhyrjet më të rëndësishme për të ruajtur kapacitetin funksional dhe për të ulur riskun e sëmundjeve kronike (Bull et al., 2020; Fragala et al., 2019). Udhëzimet ndërkombëtare rekomandojnë për të rriturit (përfshirë 40–64 vjeç) 150–300 minuta aktivitet aerobik me intensitet të moderuar në javë (ose 75–150 minuta intensiv), si dhe ushtrime forcimi për të gjitha grupet kryesore muskulore të paktën 2 ditë në javë (Bull et al., 2020). Ky kombinim është thelbësor sepse adreson njëkohësisht sistemin kardiovaskular, metabolik, muskuloskeletor dhe shëndetin mendor.

Stërviija rezistive (me pesha, makina, elastikë, ose peshë trupi) është ndër mënyrat më efektive për të rritur forcën dhe për të ruajtur/rritur masën muskulore, duke kundërshtuar rënien e lidhur me moshën. Evidenca nga rishikime sistematike dhe meta-analiza në popullata të rritura/ të moshuara tregon përmirësime domethënëse në forcë dhe funksion fizik, veçanërisht kur stërviija e rezistencës kombinohet me ushqyerje të përshtatshme (p.sh., proteinë e mjaftueshme) (Shen et al., 2023; Fragala et al., 2019). Nga perspektiva praktike, rritja e forcës pas moshës 40 vjeç lidhet drejtpërdrejt me ruajtjen e pavarësisë funksionale (p.sh., ngjitja e shkallëve, ngritja e objekteve, stabiliteti postural) dhe reduktimin e riskut për dëmtime në aktivitetet e përditshme (Fragala et al., 2019). Ushtrimet në palestër ndikojnë pozitivisht në parametrat kardiovaskularë. Aktiviteti aerobik përmirëson kapacitetin cardiopulmonar dhe ul riskun kardiovaskular, ndërsa stërviija e forcës ka treguar efekte të favorshme edhe në presionin e gjakut, sidomos te individët me risk metabolik (Bull et al., 2020). Në mënyrë specifike, rishikimet tregojnë se stërviija rezistive mund të ulë presionin sistolik (dhe në disa raste edhe atë diastolik), përfshirë individët me sindromë metabolike, një gjendje që bëhet më e shpeshtë pas moshës së mesme (Lemes et al., 2016). Gjithashtu, forma të veçanta si stërviija izometrike janë studiuar për efektet në uljen e presionit të gjakut dhe konsiderohen opsion i zbatueshëm në disa individë (Smart et al., 2019). Pas moshës 40 vjeç, rritet prevalenca e rezistencës ndaj insulinës dhe diabetit tip 2. Evidenca sugjeron se stërviija e rezistencës përmirëson kontrollin glikemik dhe profilin lipidik, sidomos te të rriturit në risk (Qadir et al., 2021). Kjo është veçanërisht e rëndësishme në palestër, sepse programet e forcës mund të individualizohen sipas gjendjes shëndetësore, duke rritur aderencën dhe sigurinë. Kombinimi i aerobikut + forcës shpesh raportohet si strategji optimale për rrezikun metabolik, sepse rrit shpenzimin energjetik, përmirëson masën e dobët trupore dhe ndjeshmërinë ndaj insulinës (Bull et al., 2020; Qadir et al., 2021). Te gratë, veçanërisht në periudhën peri-menopauzës dhe pas menopauzës, rritet risku për ulje të densitetit mineral kockor. Rishikime sistematike dhe meta-analiza mbi gratë pas menopauzës raportojnë se ndërhyrjet me ushtrime (përfshirë komponentë rezistivë dhe/ose aerobikë) kanë efekte pozitive në densitetin kockor, sidomos kur janë të strukturuar dhe afatgjata (≥ 6 muaj) (Mohebbi et al., 2023). Kjo e bën palestrën një ambient praktik për programe forcimi dhe ngarkese mekanike të kontrolluar, që synojnë parandalimin e osteoporozës.

Përtej efekteve fizike, ushtrimi i rregullt është një ndërhyrje me ndikim të matshëm në shëndetin mendor. Një meta-analizë e madhe në rishikim sistematik raporton se ushtrimi ka efekte të moderuara në reduktimin e simptomave depresive, duke e bërë atë komponent të rëndësishëm të qasjeve mbështetëse (Noetel et al., 2024). Kjo është veçanërisht relevante pas moshës 40 vjeç, ku

stresi, ngarkesa profesionale/familjare dhe ndryshimet biologjike mund të rrisin vulnerabilitetin ndaj simptomave të ankthit dhe depresionit.

Evidenca epidemiologjike tregon lidhje të qëndrueshme mes aktivitetit fizik dhe uljes së riskut të vdekshmërisë nga të gjitha shkaqet. Studime të mëdha kanë treguar se përmbushja e rekomandimeve të aktivitetit fizik shoqërohet me risk më të ulët vdekshmërie dhe se ky përfitim është i dukshëm në të gjitha grupmoshat (Martinez-Gomez et al., 2024). Po ashtu, edhe rritja e thjeshtë e lëvizjes ditore (p.sh., hapa) lidhet me ulje progresive të riskut të vdekshmërisë deri në një nivel që ndryshon sipas moshës (Paluch et al., 2022).

Për një popullatë >40 vjeç, literatura thekson rëndësinë e progresionit gradual, teknikës së saktë, volumit të përshtatshëm dhe kombinimit të forcës me aerobikun. Udhëzimet profesionale sugjerojnë minimalisht 2 ditë/javë stërvitje forcimi, me punë për grupet kryesore muskulore, dhe progresion sipas tolerancës (American College of Sports Medicine, 2009; Bull et al., 2020). Për disa individë me faktorë risku (p.sh., hipertension i pakontrolluar, sëmundje kardiake, probleme muskuloskeletore), është e rëndësishme vlerësimi paraprak dhe mbikëqyrja profesionale (Fragala et al., 2019).

2.5 Pjesëmarrja në Fitnes në Europë, Ballkan dhe Shqipëri.

Në nivel europian, pjesëmarrja në aktivitet fizik të rregullt mbetet një sfidë e rëndësishme për shëndetin publik. Të dhënat e Eurobarometer tregojnë se një përqindje e konsiderueshme e qytetarëve europianë raportojnë mungesë të aktivitetit fizik, ndërsa vetëm një pjesë e popullsisë angazhohet në mënyrë të rregullt në ushtrime fizike të strukturuar (European Commission, 2022). Brenda këtij konteksti, qendrat e fitnesit dhe palestrat përfaqësojnë një nga format kryesore të aktivitetit fizik të organizuar, veçanërisht në zonat urbane. Raportet europiane evidentojnë se pjesëmarrja në palestra fitnesi është më e përhapur në vendet e Evropës Veriore dhe Perëndimore, ndërsa vendet e Evropës Jugore dhe Lindore shfaqin nivele më të ulëta anëtarësimi (European Commission, 2022). Këto dallime shpjegohen nga faktorë socio-ekonomikë, kulturorë dhe strukturalë, përfshirë të ardhurat, arsimin, politikat kombëtare të shëndetit dhe aksesin në infrastrukturë sportive. Nga perspektiva e industrisë, sektori europian i fitnesit ka shënuar rritje të vazhdueshme në numrin e anëtarëve dhe të ardhurave, duke reflektuar një interes gjithnjë e më të madh për shërbimet e shëndetit dhe mirëqenies (EuropeActive & Deloitte, 2024). Kjo rritje lidhet me diversifikimin e ofertës së palestrave, përfshirjen e shërbimeve wellness dhe rritjen e ndërjegjësimit për përfitimet shëndetësore të aktivitetit fizik.

Në vendet e Ballkanit dhe Evropës Juglindore, pjesëmarrja në palestra fitnesi paraqitet më e kufizuar krahasuar me mesataren e Bashkimit Europian. Studimet tregojnë se aktiviteti fizik në këto vende shpesh realizohet në forma jo të strukturuar, ndërsa anëtarësimi në palestra ose klube sportive mbetet relativisht i ulët (European Commission, 2022). Literatura akademike për Ballkanin Perëndimor është më e fragmentuar dhe fokusohet kryesisht në grupe specifike të

popullsisë, si studentët universitarë. Një studim mbi studentët e mjekësisë në Ballkanin Perëndimor raportoi nivele të moderuara të aktivitetit fizik, duke theksuar se edhe grupet me njohuri të larta shëndetësore nuk janë domosdoshmërisht fizikisht aktive (Grujić et al., 2022). Faktorë si ngarkesa akademike, mungesa e kohës, infrastruktura e kufizuar dhe motivimi i ulët u identifikuan si barrierat kryesore për pjesëmarrje. Raportet e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik theksojnë se vendet e Ballkanit Perëndimor përballen me pabarazi socio-ekonomike dhe sfida strukturore që ndikojnë drejtpërdrejt edhe në sjelljet shëndetësore, përfshirë aktivitetin fizik dhe pjesëmarrjen në shërbime fitnesi (OECD, 2021). Këto kushte kufizojnë aksesin në palestra, veçanërisht për grupet me të ardhura të ulëta.

Në Shqipëri, aktiviteti fizik i pamjaftueshëm përbën një problem të rëndësishëm shëndetësor. Analizat e bazuara në të dhënat e Anketës Demografike dhe Shëndetësore Shqiptare (ADHS) 2017–2018 tregojnë se një përqindje e lartë e të rriturve nuk përmbushin rekomandimet minimale për aktivitet fizik, me diferenca të dukshme sipas gjinisë dhe moshës (Çule et al., 2022). Megjithatë sektori i palestrave fitnesi ka njohur zhvillim gradual, veçanërisht në zonat urbane, mungon një databazë zyrtare dhe e standardizuar për numrin e palestrave, anëtarësimin dhe profilin e pjesëmarrësve. Raporti “FIT ALBANIA” evidenton se shumica e palestrave janë të përqendruara në Tiranë dhe qytetet e mëdha, duke reflektuar pabarazi territoriale në aksesin ndaj shërbimeve fitnesi (ASSA, 2018). Literatura shqiptare mbi pjesëmarrjen specifike në palestra fitnesi mbetet e kufizuar dhe fragmentare. Shumica e studimeve fokusohen në aktivitetin fizik në përgjithësi, ndërsa mungojnë studime empirike që analizojnë frekuencën e stërvitjes në palestra, motivet e pjesëmarrjes, barrierat ekonomike dhe lidhjen me indikatorë të shëndetit fizik dhe mendor. Ky boshllëk shkencor thekson nevojën për kërkime të mëtejshme në këtë fushë.

Në krahasim me vendet e Evropës Perëndimore, pjesëmarrja në palestra fitnesi në Ballkan dhe Shqipëri karakterizohet nga nivele më të ulëta anëtarësimi dhe akses më i kufizuar. Ndërsa në Europë palestrat janë integruar gjithnjë e më shumë në strategjitë e shëndetit publik dhe të mirëqenies, në Ballkan dhe Shqipëri ato mbeten kryesisht iniciativa private, me mbështetje të kufizuar institucionale (EuropeActive & Deloitte, 2024; OECD, 2021). Megjithatë, potenciali për zhvillim është i konsiderueshëm, veçanërisht duke pasur parasysh nivelin e lartë të inaktivitetit fizik dhe rritjen e ndërgjegjësimit për shëndetin. Në këtë kuadër, palestrat fitnesi mund të luajnë një rol kyç në promovimin e një stili jetese aktiv dhe në reduktimin e barrës së sëmundjeve kronike në Shqipëri. Rishikimi i literaturës tregon se, ndonëse pjesëmarrja në fitnes është gjerësisht e studiuar në Europë, ekzistojnë boshllëqe të rëndësishme kërkimore në Ballkan dhe veçanërisht në Shqipëri. Mungesa e të dhënave të standardizuara dhe studimeve longitudinale kufizon kuptimin e plotë të rolit të palestrave fitnesi në shëndetin publik. Këto boshllëqe justifikojnë nevojën për studime empirike që analizojnë pjesëmarrjen në palestra fitnesi në kontekstin shqiptar, duke integruar dimensione fizike, psikologjike dhe sociale, si dhe duke ofruar evidencë shkencore për politikëbërje dhe ndërhyrje shëndetësore.

2.6 Metodatat e përshtatshme për të përmirësuar aftësitë fizike për të rriturit mbi 40-vjeç.

Një aktivitet fizik i përshtatshëm është dhe stërvitja me karakter force dhe qëndrueshmërie. Sipas parashikimeve numri i individëve të moshës së tretë parashikohet të dyfishohet deri në vitin 2050 me afërsisht 1.5 miliard (Werner, 2010). Gjithësesi ekzistojnë disa programe ndërhyrëse që ndihmojnë në ngadalësimin e uljes së funksioneve fizike. Një nga këto programe është dhe stërvitja e forcës për të parandaluar ose vonuar kufizimet e lëvizjes te individët e moshës së tretë. Sipas Chmelo et al., (2015) stërvitja e forcës është rekomanduar për të përmirësuar funksionet fizike te individët e moshës së tretë. Megjithatë është fuqia e muskujve ajo që është shfaqur si një faktor kyç në funksionet fizike. Studiuesi Reid et al., (2014) vërtetoi që është fuqia muskulare ajo që zvogëlohët me ritëm të shpejtë krahasuar me forcën muskulare gjatë periudhës së moshimit.

Studimi i (Ratamess et al., 2009) paraqet këndëvështrimet e ACSM (Kolegji amerikan i mjekësisë sportive) me titull “Modelet progresive në stërvitjen e rezistencës për të rriturit e shëndetshëm” (ACSM. 2002). Këndëvështrimi i ACSM në 2002 zgjeroi njohuritë rreth stërvitjes rezistente që ishin vendosur në fillim po nga ACSM, që lidhen me sasinë dhe cilësisë e ushtrimeve të stërvitjes rezistente për të përmirësuar fitnesin kardivaskular, muskular dhe fleksibilitetin te të rriturit e shëndetshëm (ACSM) ku rekomandojnë 8-10 ushtrime (ku këto ushtrime aktivizojnë grupe muskulare kryesore) me 8-12 përsëritje për të rriturit e shëndetshëm dhe për personat e moshuar rekomandohet 10-15 përsëritje.

Pra ACSM në 2002 ofroi një kornizë ose tablo me udhëzime rreth stërvitjes rezistente te të rriturit e shëndetshëm (pa sëmundje ose kufizime ortopedike). Këto udhëzime japin ndryshime të shumica me qëllim për t'u përshtatur individëve që kërkojnë zhvillimin muskular. Për të ndihmuar në adaptimin e forcës muskulare dhe performancës janë publikuar shume studime që shqyrtojnë variablat e stërvitjes rezistente. Nëpërmjet këtyre studimeve kanë përfshirë mekanizmat e përshtatjeve fiziologjike duke forcuar aspektin shkencor të njohurive të stërvitjes rezistente. Këndëvështrim dhe interpretimi i rekomandimeve duhet të përshtatet me qëllimin e individit, kapacitetet e tij si dhe me përvojën e tij në aktivitetin fizik. Progresiviteti i stërvitjes rezistente është cilësuar si një avancim drejt një qëllimi të caktuar derisa ai qëllim të realizohet ndërsa mbajtja e stërvitjes rezistente konsiderohet si ruajtja e gjendje aktuale të fitnesit muskular (ACSM.2002). Harmonizimi ose përdorimi i duhur i variablave si seleksionimi i ushtrimeve, pushimet, numri i seteve, numri i përsëritjeve, frekuenca ndikojnë në rritjen e nivelit të fitnesit muskular. Fuqia, qëndrueshmëria muskulare, forca muskulare dhe hipertrofia muskulare janë karakteristikat që duhet të stërviten (Ratamess et al., 2009). Stërvitja rezistente përmirëson variabla të tillë si shpejtësi, shkathtësi, kërcimin, fleksibilitetin, kordinimin si dhe variablat e tjerë të performancës motore.

Ndërsa në një program gjithëpërfshirës stërvitja rezistente përmirëson sistemin kardiovaskular (Fleck. 1988), kufizon rrezikun që vjen nga sëmundjet koronare të zemrës (Goldberg. 1989; Hurley & Kokkinos, 1987), ndihmon në parandalimin e osteoporozës (Layne & Nelson. 1999), largon

rrezikun e diabetit (Miller et al., 1984), promovon mbajtjen e një peshe të shëndetshme dhe humbjen e peshave të tepërta (Evans. 1999), redukton riskun e kancerit në shtyllën kurrizore (Koffler et al., 1992), ndihmon në mirëqënien psikologjike/mendore (Ewart. 1989) si dhe përmirëson stabilitetin dinamik dhe ruajtjen e kapacitetin funksional (Evans. 1999). Ky këndvështrim bazohet në evidencat e dala nga Instituti Kombëtar i Zembrës, Mushkërisë dhe Gjakut (National Institutes of Health and National Heart, Lung, and Blood Institute. 1998).

2.7 Parimet e progresivitetit (avancimit)

Tre janë parimet kryesore të progresivitetit: specifikimi, variacioni dhe ngarkesat (Kraemer & Ratamess, 2004). Dizenjimi i këtyre parimeve krijon modele të ndryshme dhe efektive të stërvitjes rezistente. Normalisht që shkalla e përmirësimit varet nga predispozitat gjenetike të individit si dhe përvoja e tij në aktivitetin fizik. Ngarkesa progresive nënkupton rritjen graduale të vështirësisë gjatë stërvitjes. Përshtatja fiziologjike e individëve pa përvojë në aktivitet fizik që aplikojnë stërvitjen rezistente në një periudhë kohore të shkurtër. Në rast se kërkojmë përmirësime të mëtejshme duhet të kemi një rritje sistematike të kërkesave të vendosura si dhe ndryshim i variablave sic janë 1) përsëritje, 2) intensiteti i ushtrimit, 3) pushimi, 4) volumi i trajnimit (Fleck & Kraemer. 1997).

2.7.1 Specifikimi

Faktorët që përcaktojnë përshtatjen fiziologjike të stërvitjes rezistente janë shpejtësia e lëvizjes (Coburn et al., 2006; Coyle et al., 1981), reagimi i muskujve të përfshirë (Dudley et al., 1991), sistemet energjitike (Tesch et al., 1989), diapazoni i lëvizjeve (Knapik et al., 1983), intensiteti dhe volumi i trajnimit (Perrine & Edgerton. 1978), grup-muskujt e stërvitur (Kraemer et al., 2004). Programet e stërvitjes rezistente më efektive janë ato që realizohen për të përmbushur një qëllim specifik të individit

2.7.2 Variacioni

Me Variacion ose të quajtur ndryshe periodizim nënkuptohet një proces i vazhdueshëm i ndryshimeve të një ose më shumë variablave të programit, në varësi të kohës me qëllim që stimuli i trajnimit të mbetet sfidues dhe efektiv. Për të lejuar që progresi të jetë i vazhdueshëm duhet që të bëhen disa ndryshime në programin e stërvitjes rezistente për shkak se trupi përshtatet shpejt. Dy variablat që ndryshojnë më tepër janë vëllimi dhe intensiteti për arsye se janë më efektiv në synime afatgjata (Stone et al., 2000).

Variacioni ndodh kur njëri nga variablat ndryshohet ose kur kemi kombinacione të variablave. Sidoqoftë volumi dhe intensiteti mbesin dy variablat më të studiura dhe më të ndryshueshme. Koncepti i periodizimit u bazua te procesi i adaptimi (Selye et al., 1976), rikuperimi dhe optimizimi

i performancës (Haˆkkinen et al., 1987). Pë të realizuar objektivat rekreative (Dolezal & Potteiger, 1998) dhe rehabilituese (Fees et al., 1998) përdoret stërvitja rezistente e periodizuar sepse është më efektive krahasuar me stërvitjen rezistente të pa periodizuar.

2.7.3 Periodizimi Klasik

Modeli i periodizimit klasik karakterizohet nga vëllimi i lartë dhe intensiteti i ulët në fillim dhe më pas gradualisht ulët vëllimi dhe rritet intensiteti. Modeli i periodizimit klasik realizohet për të përmirësuar variablat kryesorë të fitnesit si (forca, rritja e zhvillimit të forcës, piku i fuqisë) për një periudhë kohore të shkurtër (Fleck, 1999). Studimet kanë treguar që stërvitja e periodizuar klasike e forcës dhe fuqisë përmirëson forcën maksimale më shumë krahasuar me stërvitjen e rezistencës (Stone et al., 1981; Stone et al., 2000). Rikuperimi është shumë i rëndësishëm në periodizimin klasik sepse eleminon mbingarkesën.

2.7.4 Periodizimi i kundërt

Rhea et al., (2003) ka studiuar modelin e periodizimit të kundërt. Ky model është e kundërta e modelit të periodizimit klasik, ku në fillimet e stërvitjes intensiteti është i lartë dhe volumi është i ulët dhe pas një kohe të gjatë intensiteti ulët ndërsa vëllimi rritet. Për të përmirësuar qëndrueshmërinë muskulare lokale rekomandohet ky model periodizimi (Ebben et al., 2004). Ndërsa për përmirësimin e forcës ky model periodizimi nuk është i rekomanduar sepse ka një rritje më të vogël krahasuar me periodizimin klasik (Rhea., 2003).

2.7.5 Periodizimi jo linear

Kjo metodë periodizimi ofron variacione në vëllim dhe intensitet brenda një cikli duke përdorur protokolle të ndryshme që stërvisin komponentë të ndryshëm neuro-muskular si fuqia dhe forca. Skema e ngarkesa për ushtrimet e korit është e lehtë, moderuar dhe e vështirë pra 3-5 përsëritje me maksimumin e ngarkesës (RM) e ndjekur nga 8-10 RM dhe 12-15 RM. Ky model përmirëson forcën më mirë krahasuar me modelin e periodizimit klasik (Rhea et al., 2002). Në krahasim me modelet e tjera të periodizimit ky model ka treguar më shumë avantazhe sidomos te femrat (Kraemer et al., 2000; Marx et al., 2001). Ekzistojnë shumë pak studime që tregojnë mbi ndikimin e stërvitjes e rezistencës me periodizim jo linear në fitnes (Newton et al., 2002).

2.8 Karakteristikat e stërvitjes

2.8.1 Forca muskulare

Të gjitha llojet e lëvizjeve kanë të nevojshme aftësinë për të gjeneruar forcë. Fibrat muskulare kros-seksionale janë përgjegjëse për gjenerimin e forcës (Finer et al., 1994). Gjenerimi i një force

të madhe muskulare vjen nga adaptimi i stërvitjes rezistente nëpërmjet mekanizmave neuro-muskular. Që në javën e parë të trajnimit forca muskulare mund të rritet ndjeshëm (Coburn et al., 2006), ku nëpërmjet funksioneve nervore të përmirësuar vjen rritja e forcës në afat të gjatë (Sakamoto & Sinclair, 2006). Lloji i programi stërvitor të përdorur ku përfshihet vëllimi, intensiteti, ushtrimet e zgjedhura, renditja e ushtrimeve, pushimi, frekuenca është përgjegjës për madhësinë e rritjes së forcës (Kraemer & Ratamess, 2004).

2.8.2 Veprimet muskulare

Programet e stërvitjes rezistente përfshijnë përsëritje dinamike, koncentrike, ekcentrike dhe izometrike. Veprimet ekcentrike janë ato që prodhojnë më shumë forcë krahasuar me veprimet koncentrike dhe izometrike (Komi et al., 1987). Veprimet ekcentrike kërkojnë më pak nga metabolizmi (Bonde-Peterson et al., 1972), janë të përshtatshme për hipertrofinë muskulare (Hather et al., 1991) si dhe janë më pak kërkuese ndaj aftësive motore (Komi et al., 1987). Kur kemi alternimin e veprimeve koncentrike dhe ekcentrike, përmirësimi i forcës muskulare është më e madhe (Dudley et al., 1991). Shumica e programeve përfshijnë të dyja veprimet. Mendohet se ushtrimet shtesë izometrike mund të sjellin përfitime më të mëdha të forcës. Studimi i Jackson et al., (1985) dhe Keogh et al., (1999) raportojnë që shtimi i ushtrimeve izometrike sjell përfitime shtesë. Sipas studimit të McGill, (2001) ushtrimet izometrike rekomandohen për shëndetin e shpinës, mbajtjen drejt të posturës si dhe për stabilizimin e shtyllës kurrizore.

2.8.3 Ngarkesat

Ngarkesat stërvitore ndikojnë në reagimet metabolike (Ratamess et al., 2007), kardiovaskulare (Fleck, 1988), hormonale (Linnamo et al., 2005) dhe nervore (Sale, 1992). Rritja e ngarkesës bëhet në një nga këto mënyra 1) rritje e bazuar nga 1 RM, 2) rritja e ngarkesës nëpërmjet rritjes së përsëritjeve, 3) bashkimi i të dyjave më lartë psh (8-10 RM). Te individët e pastërvitur më parë rekomandohet ngarkesa prej 45-50% të 1 RM (Weiss et al., 1998). Te individët që bëjnë stërvitje të moderuar është raportuar që ngarkesat e ulëta me 15-25 përsëritje rrisin forcën (Rhea et al., 2003). Sipas Häkkinen et al., (1986) duhet 80% i 1 RM që të ketë më tepër progresivitet dhe përshtatje të mëtejshme nervore. Për të përmirësuar forcën maksimale dinamike duhet stërvitje me ngarkesa 1-6 RM sidomos (5-6 RM) (Berger et al., 1962). Kur përdorim pesha të rënda me 3-5 RM kemi rritje më të madhe të forcës (Campos et al., 2002). Pavarësisht se në studimet e (Kraemer et al., 1997; Kraemer et al., 1987) raportohet që për rritjen e forcës përdoren 8-12 RM. Stërvitja rezistente e periodizuar ka nevojë për skema ngarkimi me intensitet të ndryshëm (Rhea et al., 2004). Kjo formë e ngarkesave me intensitet të ndryshëm është më i favorshëm për rritjen e forcës maksimale krahasuar me ngarkesën 6 RM (Fleck, 1999). Konkluzionet e analizës raportojnë që për të rritur forcën te individët fillestarë në aktivitetin fizik duhet një ngarkesë 60% të 1 RM, për individët e stërvitur ngarkesa duhet 80% e 1 RM, ndërsa për sportistët ngarkesa duhet 85% e 1 RM (Peterson et al., 2004). Mësimi i teknikës është parësore te individët fillestarë dhe më pas vjen

ngarkesa (50%-60% e 1 RM). Përdorimi i ngarkesave të ndryshme duhet të jetë më efektive për improvizimin e forcës muskulare (Kraemer & Ratamess, 2004). Përcaktimi i intensiteti duhet të bëhet në bazë të pragut të individit.

2.8.4 Frekuenca

Faktorët nga të cilët varet frekuenca optimale e stërvitjes rezistente janë vëllimi, intensiteti, rikuperimi dhe përzgjedhja e ushtrimit. Hickson et al., (1994) dhe shume studime të tjera kanë përdorur frekuencën 2-3 herë në javë. Kjo është një frekuencë fillestare efektive ndërsa frekuenca 1-2 herë në javë shërben për mirëmbajtje të personave që janë tashmë të angazhuar në stërvitjen rezistente (Graves et al., 1988). Për të përmirësuar forcën shumë studime kanë dalë në konkluzionin që 3 ditë stërvitje në javë është më mirë se 2 ditë stërvitje në javë dhe 4 ditë stërvitje në javë është më mirë se 3 ditë stërvitje në javë (Graves et al., 1988; McLester et al., 2000). Përmirësimi i forcës të individët pa eksperiencë në aktivitetin fizik është më i lartë kur frekuenca e përdorur është 3 herë në javë (Rhea et al., 2003).

2.8.5 Vëllimi

Vëllimi i stërvitjes është përcaktuar si një përmbledhje e numrit të përsëritjeve (shumëzuar) në raport me rezistencën e përdorur dhe kohëzgjatjen e aktivizimit të muskujve (Tran et al., 2006). Vëllimi ndikon në sistemin nervor (Haˆkkinen et al., 1988), sistemin metabolik (Ratamess et al., 2007), hipertrofi (Tesch et al., 1987) dhe në sistemin hormonal (Newton et al., 2002). Variablat e tillë, si numri i ushtrimeve të kryera për seancë, numrin e përsëritjeve të kryera për set dhe numrin e seteve për ushtrim ndikojnë në ndryshimin e vëllimit të stërvitjes. Karakteristikat e stërvitjes rezistente janë numri i lartë/moderuar i seteve, ngarkesë e lartë dhe përsëritje e ulët. Studimet kanë raportuar një rritje të forcës muskulare të individët e stërvitur dhe ato më pak të stërvitur kur kemi 2 sete për ushtrim (Dudley & Djamil, 1985), 3 sete për ushtrim (Kraemer, 1987), 4-5 sete për ushtrim (Hortobagyi et al., 1996), 6 ose më shumë sete për ushtrim (Housh et al., 1992). Rritja e forcës është e njëjtë ndërmjet 1-2 sete dhe 2-4 sete ndërsa 3 sete raportohen të kenë një rritje më të madhe (Berger et al., 1962). Nga një meta-analizë është vërtetuar që 8-sete për secilin grup-muskul japin efektin më të madh të atletët (Peterson et al., 2004; Peterson et al., 2005). Ekziston një ndarje e studimeve që raportojnë që ekzistojnë një rritje e njëjtë e forcës ndërmjet një seti të vetëm dhe disa seteve (Coleman, 1977; Jacobson et al., 1986) dhe studimet që tregojnë që disa sete sjellin më tepër përmirësim se një set i vetëm (Sanborn et al., 2000; Stone et al., 1979). Që nga 2002 studimet kanë treguar që disa sete kanë përmirësim të forcës dinamike me vlera 33- 100% (McBride et al., 2003; Paulsen et al., 2003).

Për individët që ushtrojnë stërvitjen rezistente, programet që kanë disa sete rrisin forcën më shumë se ato ushtrime që përfshijnë vetëm një set (Kraemer et al., 2000). Te gratë pas menopauzës stërvitja rezistente me disa sete rrit forcën me 3.5-5.5 % ndërsa rritja e forcës me stërvitjen e rezistencës me një set të vetëm është 1-2% (Kemmler et al., 2004). Të dyja format e programeve me disa sete

dhe me vetëm një set janë efektive në rritjen e forcës për një kohëzgjatje të shkurtër. Rritja e moderuar e vëllimit të trajnimit është e nevojshme për përmirësime të mëtejshme sidomos te studimet me kohëzgjatje të madhe (McCaw & Friday, 1994).

2.9 Ushtrimet pa pesha dhe makineritë

Makineritë janë përdorur si paisje të sigurta dhe shumë të thjeshta për tu mësuar dhe shumë të përshtatshme për të realizuar ushtrime që janë të vështira për tu bërë pa pesha. Makineritë limitojnë lëvizjet duke ndihmuar në stabilitet dhe në prodhimin e një force sinergjike (McCaw et al., 1994). Ndërsa për të zbatuar kërkesat e një lëvizje specifike përdoren ushtrimet pa pesha sepse ndikojnë në kordinimin intermuskular. Të dyja format si makineritë ashtu dhe ushtrimet me pesha të lira ndihmojnë në rritjen e forcës. Zgjedhja e secilës formë duhet të varet nga niveli i trajnimit të individit si dhe objektivi i stërvitjes.

2.10 Renditja e ushtrimeve

Renditja e ushtrimeve bëhet dhe nga aktivizimi i muskujve antagonist/ agonist. Forca dhe fuqia muskulare mund të rritet në dy forma, forma nr. 1 kur kemi ushtrime që stimulojnë lëvizjet antagoniste (Baker & Newton, 2005) dhe forma nr. 2 është kur kryhen ushtrime të njëpasnjëshme (Ballor et al., 1987). Sipas studimit Simao et al., 2005 ushtrime të tilla si (squat, bench, leg and shoulder press) e japin efektin e tyre më mirë kur aplikohen në fillim të stërvitjes sepse kur aplikohen pas disa ushtrimeve të tjera që aktivizojnë po të njëjtat muskuj. Ushtrimet që përfshijnë disa artikulacione në ekzekutimin e tyre janë rezultative në rritjen e forcës dhe fuqisë muskulare (Spreuwenberg et al., 2006).

2.11 Pushimi

Gjatë stërvitjes rezistente apo cdo stërvitje tjetër pushimi ndërmjet seteve apo ushtrime ndikon në sistemin metabolik dhe hormonal si dhe në vetë përgjigjen që jep stërvitja te parametrat e ndryshëm fizik (Ratamess et al., 2007; Kraemer & Ratamess, 2007). Gjithashtu dhe forca muskulare është e ndikuar nga pushimi dhe shumë pak informacione ka se sa ndikohet hipertrofia muskulare nga pushimi. Studimi i (Robinson et al., 1995) raporton që nuk kishte asnjë ndryshim sinjifikativ në perimetrin e muskulit, në kompozicionin e trupit dhe përqindja dhjamore te periudhat e pushimit 30-90-180 sekonda te meshkujt që u stërvitët për 5 javë. Studimi i Ahtiainen et al., 2005 tregoi që rritja e perimetrit të muskulit ishte e njëjtë si në interval pushimi 5 minuta ashtu dhe në 2 minuta kur aplikohet një program stërvitore 3-mujorë. Përgjigjet akute hormonale dhe nabolike më të mëdha janë kur kemi pushime me intervale të shkurta pas ushtrimeve me intensitet dhe vëllim të lartë në të moderuar (Kraemer et al., 1990). Këto përgjigje akute hormonale japin më tepër efekt te hipertrofia muskulare sesa te ndryshimet kronike (McCall et al., 1999). Pra intervalet e pushimit varen dhe nga intensiteti i stërvitjes.

2.12 Shpejtësia e veprimeve muskulare

Shpejtësia e kontraksioneve muskulare prek sistemin nervor, metabolik dhe hipertrofinë gjatë kryerjes së një veprimi dinamik si përgjigje të stërvitjes rezistente (Ha`kkinen et al., 1987). Studimi i Kanehisa & Miyashita, (1983) ka raportuar që stërvitja isokinetike rrit shpejtësinë dhe forcën specifike. Studimi i Sforzo & Touey, (1996) tregon që stërvitja me shpejtësi të moderuar prodhon një forcë më të madhe. Reduktim të prodhimit të forcës kemi kur ngarkesa është e lartë dhe përsëritjet bëhen të ngadalta. Duhet theksuar që ekzistojnë dy lloje të kontraktimit me shpejtësi të ngadaltë të stërvitja rezistente të qëllimshme dhe të paqëllimshme. Gjatë përsëritjeve me intensitet të lartë, kur ngarkesa dhe lodhja përcaktojnë ritmin e kohëzgjatjen e përsëritjeve përdoret kontraktimi me shpejtësi të ngadaltë të paqëllimshëm (Mookerjee & Ratamess, 1999). Ndërsa në të kundërtën përdoren kontraktimet me shpejtësi të ngadaltë të qëllimshme. Shpenzimi i energjisë është më i ulët kur përdoren kontraktimet me shpejtësi të ngadaltë të qëllimshme (Mazzetti et al., 2007). U vunë re që forca dhe shpejtësia ishin më të larta kur shpejtësia e kontraktimit muskular ishte e qëllimshme sesa kur ishte e paqëllimshme (Hatfield et al., 2006).

2.13 Hipertrofia muskulare

Dihet që përmes proceseve metabolike, hormonale dhe mekanike stërvitja rezistente shkakton hipertrofinë muskulare (Kraemer et al., 1987). Hipertrofia përfshin struktura të vogla proteinike siç janë aktina dhe miozina si dhe stuktura të tjera. Kur themi që përfshin proceset metabolike nënkupton që ndodhin një sërë ngjarjesh nënqelizore. Stërvitja rezistente rregullon faktorët frenues të rritjes, ndryshon aktivitetin e 70 geneve (Roth et al., 2002). Studimi i Phillips et al., 1997 sintheza e proteinave të muskujve skeletorë rritet 24 orë pas ushtrimeve të fuqishme të stërvitjes rezistente. Ky mjedis anabolik mbetet konstant 2-3 orë mbas ushtrimit deri në 36-48 orë mbas ushtrimit (MacDougall et al., 1995). Faktorët e tjerë që ndikojnë në hipertrofinë muskulare janë: lloji i fibrave, marrja e aminoacideve, veprimet muskulare, formimi i metabolitit, përgjigjet endokrine (Fujita et al., 2007). Hipertrofia muskulare përfshin si veprimin metabolik ashtu dhe veprimin mekanik (si psh ngritja e peshave të rënda, vëllimi mesatar në të ulët). Në fazat e para të stërvitjes mbizotëron përshtatja nervore përta i përket hipertrofisë muskulare (Moritani & DeVries, 1979). Brenda 6- javëve të para hipertrofia muskulare bëhet e dukshme (Phillips, 2000) ndërsa proceset nënqelizore fillojnë ndryshimet e tyre më herët (Staron et al., 1994). Të gjitha këto të dhëna më lartë tregojnë që mbingarkesa progresive është tepër e nevojshme për rekrutimin maksimal të fibrave muskulare dhe si pasojë hipertrofinë e fibrave muskulare. Gjithashtu kjo tregon që kur të dizenjojmë programe ushtrimore duhet të targetojmë të dy faktorët hipertrofik dhe nervorë për të marrë maksimumin e forcës dhe hipertrofisë.

Shpenzimet shtetërore për moshën e tretë janë të larta prandaj mund të konsiderohet si një investim afatgjatë për shoqërinë, projektet që suportojnë njerëzit që janë në marrëdhënie pune. Normalisht aktiviteti fizik të njerëzit e rritur dhe të moshuar është delikat dhe ka përqindje rreziku ose gabimi.

Stërviŧja e forcës sjell ndryshime në presionin e gjakut dhe reagimin e papritur të trupit. Kjo gjë prek veçanërisht njerëzit që kanë probleme me sistemin kardivaskular. Për këtë arsye doktorët nuk e rekomandojnë stërviŧjen rezistente pavarësisht se stërviŧja me pesha nuk nënkupton intensitet të lartë.

Sipas studimeve (Fried & Guralnik, 1997; Janssen et al., 2002; Bergen et al., 2014) plakja shoqërohet me uljen e funksioneve fizike, humbjen e pavarësisë fizike si pasojë dhe me uljen e cilësisë së jetesës. Studimi i Katz et al. (1983) theksoi se zgjatja e jetëgjatësië duhet të shoqërohet patjetër me ruajtjen e mirë të funksioneve fizike. Sipas parashikimeve numri i individëve të moshës së tretë parashikohet të dyfishohet deri në vitin 2050 me afërsisht 1.5 miliard (Werner, 2010). Gjithsesi ekzistojnë disa programe ndërhyrëse që ndihmojnë në ngadalësimin e uljes së funksioneve fizike. Një nga këto programe është dhe stërviŧja e forcës për të parandaluar ose vonuar kufizimet e lëvizjes te individët e moshës së tretë. Sipas Chmelo et al. (2015) stërviŧja e forcës është rekomanduar për të përmirësuar funksionet fizike te individët e moshës së tretë. Megjithatë është fuqia e muskujve ajo që është shfaqur si një faktor kyç në funksionet fizike. Studiuesi Reid et al. (2014) vërtetoi që është fuqia muskulare ajo që zvogëlohet me ritëm të shpejtë krahasuar me forcën muskulare gjatë periudhës së moshimit. Shumë studime të tjera si (Skelton et al., 1994; Foldvari et al., 2000; Bean et al., 2007) raportojnë që funksionet fizike janë më tepër të lidhura me fuqinë e muskujve sesa me forcën ose masën muskulare. Stërviŧja e fuqisë ka më shumë përfitime në funksionet fizike të moshës së tretë krahasuar me stërviŧjen tradicionale të forcës (Tschopp et al., 2011; Da Rosa., 2019). Në këto studime bëjnë pjesë dhe stërviŧja pliometrike me ushtrime të tilla si (CMJ dhe depth jump) (Miszko et al., 2003; Ramirez-Campillo et al., 2014). Sipas Vetrovsky et al. (2019) ndryshe nga stërviŧja e fuqisë e cila përdor ekcentrikën e ngadaltë në të kontrolluar, stërviŧja pliometrike përdor ekcentriken e shpejtë. Studimet e mëparshme që kanë studiuar ndikimet e stërviŧjes së fuqisë kanë përdorur ndërhyrje të ndryshme. Si shembull jepet, që për grupin eksperimental janë përdorur ushtrime të stërviŧjes së fuqisë në këmbë ndërsa në grupin e kontrollit janë përdorur ushtrime të stërviŧjes së fuqisë ulur (Bean et al., 2009). Përfshirja e shumë programeve ndërhyrëse e bën të vështirë të kuptohet ndikimi që ka stërviŧja e fuqisë në funksionet fizike.

Disa lloje të stërviŧjes së forcës kërkojnë një metodologji të veçantë (Stefaniak, 2006; Zajac et al., 2010). Përpara se të fillosh një program trajnimi duhet të aplikosh një cikël përgatitor për tu përshtatur programit të mëvonshëm. Ky cikël përgatitor mund të zgjasë nga disa javë në disa muaj dhe ka një vlerë shëndetësore dhe vetë-edukuese për të nxitur njerëzit të merren me aktivitet fizik. Stërviŧja rezistente shkakton ndryshime biokimike në muskujt skeletor dhe në këtë mënyrë përmirëson funksionet e të gjithë trupit (Wernbom et al., 2007). Stërviŧja rezistente shkakton rritje të aktivitetit të proteinave të kolagenit e cila ndikon në rritjen e qarkullimit të muskujve (Burd et al., 2010). Studimi i Davis et al. (2008) vërtetoi që kombinimi i stërviŧjes së forcës dhe stërviŧjes aerobike 11 javore përmirëson qëndrueshmërinë dhe forcën. Grupi që stërviŧet me intensitet të lartë ndryshon përbërjen trupore më shumë krahasuar me grupin që stërviŧet me intensitet të ulët. Shumë literatura sugjerojnë përdorimin e ushtrimeve rezistente. Si përfundim studimi i Davis et al. (2008)

vërtetoi që kombinimi i stërvitjes së forcës dhe stërvitjes aerobike 11 javore përmirëson qëndrueshmërinë dhe forcën.

Në studimin e Marques et al. (2011) stërvitja rezistente solli ndryshime pozitive në dendësinë e kockave (te femrat) reduktimin e yndyrës dhe përmirësimin e ekuilibrit. Gjithashtu dhe studiuesi Borer (2005) konfirmoi ndryshime në frenimin e osteoporozës pas aplikimit të stërvitjes rezistente. Studiuesit Willis et al. (2012) dhe Ormsbee et al. (2009) vërtetuan që ushtrimet izometrike përmirësojnë metabolizmin në qetësi.

Qëllimi i studimit të Kalwa et al. (2019) është gjetja e një metode të përshtatshme për të frenuar proceset involucionare si dhe për të përmirësuar aftësitë fizike të njerëzve mbi 40-vjeç. Gjithashtu ky punim ka për qëllim përcaktimin e ngarkesave dhe doza e përpjekjeve fizike të cilët duhen të shikohen me kujdes për të mos patur dëmtime dhe për të eliminuar efektet negative të stërvitjes rezistente. Në këtë studim morën pjesë 178 të rritur ku 92 ishin femra dhe 86 meshkuj të moshës 40-61 vjeç. Ata morën pjesë në një program stërvitorë 8 mujor. Pjesëmarrësit në studim u ndanë në dy grupe- grupi 1 (51 -61 vjeç) dhe grupi 2 (40-50 vjeç). Përpara aplikimit të programit të forcës u realizua një cikël trajnimi parapërgatitor. Stërvitja u realizua 3 herë në javë. Dy ushtrime u realizuan për secilën pjesë kryesore trupore. 15 minuta nxehja dhe 60-80 minuta stërvitja e forcës si dhe 10 minuta stretching. Rezultatet finale nga ky studim tregojnë që programi stërvitor jep efekte të dobishme në luftën kundër simptomave të plakjes. Të dhënat treguan ndryshime në përbërjen trupore dhe fitnesin fizik në te dyja grupet, por grupi ku u aplikua stërvitja me intensitet më të lartë pati ndryshime më të mëdha. Përmirësimi i fitnesit u vu re si te femrat ashtu dhe te meshkujt. Në fitnesin fizik u vunë re ndryshimet më të medhaja. Objektivi kryesorë i këtij studimi ishte zgjatja e jetëgjatësisë dhe përmirësimi i cilësisë së jetesës dhe shëndetit.

Meta-analiza e studimit të Balachandran et al. (2022) vlerësuan ndikimin e stërvitjes së fuqisë në funksionet fizike të moshës së tretë. Nga numri i pakët i gjetjeve rezultuan që stërvitja e fuqisë sjell përmirësime në funksionet fizike më shumë se stërvitja e forcës tradicionale. Studimi i mësipërm vlerësoi vetëm meta-analiza ose studime që lidhen me stërvitjen e forcës pa përdorur ushtrime pliometrike. Dy studime të tjera nuk u përfshinë në këtë meta-analizë sepse në grupin eksperimental u bënë ushtrime të stërvitjes së fuqisë në këmbë ndërsa në grupin e kontrollit janë përdorur ushtrime të stërvitjes së fuqisë ulur (Bean, 2004).

Gjithashtu dhe dy studime të tjera nuk u përfshinë në analizë sepse performuan CMJ (Miszko et al., 2003), dhe studimi i dytë kombinoi stërvitjen e fuqisë me stërvitjen e fuqisë (Balachandran et al., 2014).

Studimi i Balachandran et al. (2022) është fokusuar vetëm të stërvitja e fuqisë pa ndërhyrjen e llojeve të tjera të stërvitjes. Për të vlerësuar funksionet fizike shumica e studimeve përdorën testin GUG dhe testin e qëndrimi në karrige. Këto dy teste të lartë përmendura përdoren në një ritëm të shpejtë ndërsa testi i *Timed up and go* përdoret në një ritëm të zakonshëm. Për testin e GUG ne vumë re një përmirësim mesatar me 1.85 sekonda SD 0.62 ndërsa për testin e qëndrimit në karrige u vu re një përmirësim më i madh me 4.3 sekonda SD 0.56. Stërvitja e fuqisë sjell një rritje të fuqisë te fibrat muskulare të tipit të dytë pa u ndikuar nga mosha dhe gjinia (Claflin et al., 1985). Sipas Lexell (1995) fibrat e tipit të dytë kanë një humbje gjatë periudhës së plakjes. Sic shikohet

përmirësimi i forcës dhe i fuqisë është përgjegjës për kufizimin e lëvizjeve (Santanasto et al., 2017). Rrjedhimisht përmirësimi i fuqisë muskulare sjell baza biologjike për përmirësimin e funksioneve fizike. Ndërsa shpejtësia e ecjes, forca dhe masa e muskujve nuk janë të lidhura. Në shumë studime janë përdorur të njëjta nivele të intensitetit dhe volumit për të dyja grupet prandaj dhe nuk pritet të kemi rezultate të ndryshme të forcës dhe masës muskulare. Ndërsa studimet që treguan përmirësime në shpejtësinë e ecjes aplikuan ecjen si program ushtrimor (Pahor et al., 2014). Efektet negative ishin minimale të të dyja grupet.

Në përfundim nga studimi i Balachandran et al. (2022) rezultuan që stërvitja e fuqisë sjell përmirësime në funksionet fizike më shumë se stërvitja e forcës tradicionale. Studimi vlerësoi vetëm meta-analiza ose studime që lidhen me stërvitjen e forcës pa përdorur ushtrime pliometrike. Për testin e GUG në vumë re një përmirësim mesatar me 1.85 sekonda SD 0.62 ndërsa për testin e qëndrimit në karrige u vu re një përmirësim më i madh me 4.3 sekonda SD 0.56. Stërvitja e fuqisë sjell një rritje të fuqisë të fibrat muskulare të tipit të dytë pa u ndikuar nga mosha dhe gjinia (Claflin et al., 1985). Sipas Lexell (1995) fibrat e tipit të dytë kanë një humbje gjatë periudhës së plakjes. Sic shikohet përmirësimi i forcës dhe i fuqisë është përgjegjës për kufizimin e lëvizjeve (Santanasto et al., 2017). Rrjedhimisht përmirësimi i fuqisë muskulare sjell baza biologjike për përmirësimin e funksioneve fizike.

2.14 Përmbledhje e diskutimit teorik

Diskusimi teorik i kësaj teze është ndërtuar mbi bazën e literaturës bashkëkohore që trajton efektet e aktivitetit fizik të strukturuar në shëndetin dhe funksionalitetin e adultëve mbi moshën 40 vjeç. Evidencat shkencore tregojnë qartë se procesi i plakjes shoqërohet me rënie graduale të forcës muskulare, fuqisë eksplozive, kapacitetit kardiovaskular, fleksibilitetit dhe kontrollit postural, duke rritur rrezikun për sedentarizëm, sëmundje kronike dhe humbje të pavarësisë funksionale. Literatura thekson se stërvitja e strukturuar, e bazuar në parimet e progresivitetit, specifikës dhe variacionit, përbën një ndër strategjitë më efektive për ngadalësimin e këtyre ndryshimeve involutive. Në veçanti, programet që kombinojnë elementë të forcës, qëndrueshmërisë muskulare, kardios, fleksibilitetit dhe ushtrimeve funksionale rezultojnë më efektive sesa qasjet tradicionale të pastrukturuara.

Një vëmendje e veçantë në diskutimin teorik i kushtohet rolit të forcës dhe fuqisë muskulare, të cilat konsiderohen determinantë kyç të performancës funksionale në moshat adulte dhe të avancuara. Studimet tregojnë se rënia e fuqisë muskulare ndodh më shpejt sesa rënia e forcës maksimale, duke ndikuar drejtpërdrejt në aftësinë për të kryer aktivitete bazike të jetës së përditshme, ruajtjen e ekuilibrit dhe parandalimin e rënieve. Gjithashtu, literatura mbështet rëndësinë e trajnimit të ekuilibrit dhe koordinimit, veçanërisht në popullatat adulte, ku integrimi i sistemeve sensoriale dhe neuromuskulare pëson degradim progresiv me rritjen e moshës. Programet që përfshijnë ushtrime funksionale dhe kërkesa të larta sensorimotorike demonstrojnë përmirësime më të qëndrueshme në kontrollin postural dhe stabilitetin dinamik.

Nga pikëpamja antropometrike dhe metabolike, diskutimi teorik evidenton se aktiviteti fizik i strukturuar ndikon pozitivisht në peshën trupore, indeksin e masës trupore dhe perimetrin e belit, megjithëse përgjigja ndaj ndërhyrjes ndryshon sipas gjinisë. Femrat, sipas literaturës, shfaqin shpesh përgjigje më të ndjeshme ndaj programeve të monitoruara dhe të strukturuar, veçanërisht në reduktimin e yndyrës abdominale, ndërsa te meshkujt efektet mund të kërkojnë ndërhyrje më afatgjata ose me intensitet më të lartë. Në përmbledhje, diskutimi teorik mbështet idenë se ndërhyrjet stërvitore të strukturuar, të dizajnuara mbi bazë shkencore dhe të përshtatura sipas karakteristikave të individit dhe gjinisë, janë thelbësore për ruajtjen e shëndetit funksional në moshat adulte. Megjithatë, literatura evidenton mungesën e studimeve eksperimentale të kontrolluara në kontekstin shqiptar, duke krijuar nevojën për kërkime empirike që vlerësojnë efektet reale të këtyre programeve në kushte praktike.

2.15 Hipotezat

2.15.1 Hipoteza kryesore (H_1)

Zbatimi i një programi 12-javor të strukturuar të aktivitetit fizik do të prodhojë përmirësime statistikisht të rëndësishme në parametrat antropometrikë, funksionalë dhe neuromuskularë te adultët mbi 40 vjeç, krahasuar me një grup kontrolli që ndjek stërvitje tradicionale.

2.15.2 Hipotezat specifike

H_{1a} – Hipoteza antropometrike

Programi i strukturuar 12-javor do të çojë në ulje të konsiderueshme të peshës trupore, BMI-së dhe perimetrin të belit, tek meshkujt dhe femrat, krahasuar me grupin e kontrollit.

H_{1b} – Hipoteza funksionale

Individët e grupit ndërhyrës do të shfaqin përmirësime domethënëse në fitnesin funksional total, të matur përmes baterisë Darden, krahasuar me grupin e kontrollit.

H_{1c} – Hipoteza e ekuilibrit dhe koordinimit

Programi i strukturuar do të përmirësojë ndjeshëm aftësitë postural.

H_{1d} – Hipoteza gjinore

Përgjigja ndaj ndërhyrjes stërvitore nuk do të jetë e ndryshme sipas gjinisë, ku femrat do të shfaqin efekte më të forta dhe më specifike të ndërhyrjes krahasuar me meshkujt.

H_0 – Hipoteza zero

Nuk do të ketë ndryshime statistikisht të rëndësishme midis grupit ndërhyrës dhe grupit të kontrollit në parametrat e studiuar pas periudhës 12-javore.

2.16 Pyetjet hulumtuese

Bazuar në analizën teorike dhe boshllëqet e identifikuar në literaturë, ky studim udhëhiqet nga pyetjet hulumtuese në vijim:

1. A ndikon një program i strukturuar 12-javor i aktivitetit fizik në përmirësimin e parametrave antropometrikë (peshë trupore, BMI, perimetër beli) te adultët mbi 40 vjeç, krahasuar me stërvitjen tradicionale?
2. Cili është efekti i një programi të strukturuar stërvitor në fitnesin funksional total, të matur përmes testeve funksionale dhe baterisë Darden?
3. A prodhon ndërhyrja stërvitore përmirësime domethënëse në ekuilibër dhe koordinim, krahasuar me stërvitjen tradicionale?
4. A ekzistojnë dallime gjinore në përgjigjen ndaj programit të strukturuar të aktivitetit fizik në aspektin antropometrik dhe funksional?
5. A është ndërveprimi Time \times Group tregues i efektivitetit specifik të ndërhyrjes, duke diferencuar ndryshimet e shkaktuara nga programi i strukturuar nga adaptimet e përgjithshme kohore?
6. Në çfarë mase programet e strukturuar dhe të monitoruara kontribuojnë në ruajtjen e pavarësisë funksionale dhe shëndetit fizik te adultët mbi 40 vjeç në kontekstin shqiptar?

Kreu III- Metodologjia e Kërkimit

3.1 Metodot

Ky studim u zhvillua mbi një program stervitor me grup ndërhyrës (16 meshkuj dhe 16 femra) dhe grup kontrolli (16 meshkuj dhe 16 femra), duke përfshirë 64 individë të rritur mbi 40 vjeç (mosha mesatare për meshkujt: 46.5 ± 8.4 vjeç; mosha mesatare për femrat: 44.1 ± 6.8 vjeç), të përzgjedhur në mënyrë rastësore nga katër palestra fitnesi në qytetin e Tiranës (të zgjedhura rastësisht nga një total prej 61 palestrash të regjistruara në Tiranë).

Ndërhyrja 12-javore, me frekuencë tri herë në javë (70 min/seancë), u karakterizua nga një protokoll i strukturuar i ngarkesës stërvitore, i kontrolluar nga instruktorë profesionistë, ndërsa grupi i kontrollit vijoi me stërvitje tradicionale.

Per grupin ndërhyrës u përdor një protokoll i veçantë mbi ngarkesën stërvitore e cila karakterizohet deri në nivele të fitnesit, duke e garantuar këtë me instruktorët që shërbejnë në palestër. Frekuenca e trajnimit ishte tri herë në javë për të dyja grupet (mbasditë) me një kohëzgjatje prej 12 javësh (70 min/ seancë stërvitore.). U kryen matje në fillim të javës së parë (pre) dhe në përfundim të studimit (post). Grupi i kontrollit ka vijuar me stërvitjen tradicionale 12 javë (3 herë në javë stërvitje; 1- 1.5 orë).

Në këtë kontekst, efekti i kohës (Time) reflekton ndryshime të përgjithshme pre–post (p.sh. adaptim fiziologjik, praktikë e testit), ndërsa ndërveprimi Time \times Group përfaqëson efektin specifik të programit ndërhyrës, i cili është treguesi kryesor për vlerësimin e efikasitetit të ndërhyrjes (Field, 2018; Tabachnick & Fidell, 2019).

Janë përdorur 8 databaze për gjetjen e studimeve si Scopus, Medline, JStore, Embase, Cochrane Central, PsycInfo, Scholar, dhe SPORTDiscus. Kishte kufizim në vitin e botimeve (10-15 vitet e fundit). Kriteret përfshirëse janë: individët duhet të jenë të shëndetshëm dhe mosha mesatare të paktën 40 vjeç. Programi ndërhyrës i stërvitjes së rezistencës përfshinte ushtrime që lidheshin me makineritë, ushtrime me peshën e trupit, biçikleta ergometrike, rrip elastik etj. Vlerësimet e funksioneve fizike u bënë nëpërmjet baterisë së testeve të performancës fizike ndërsa matjet që lidhen me fuqinë ndërsa matjet e tjera përfshinë forcën dhe fuqinë e gjymtyrëve të poshtme dhe të sipërme, masën muskulare, masën dhjamore.

Në këtë studim janë përdorur testime të standardizuara për të vlerësuar në mënyrë të plotë ndryshimet antropometrike, funksionale dhe të performancës fizike të pjesëmarrësit. Më poshtë paraqiten në mënyrë të strukturuar të gjitha matjet dhe testet e përdorura gjatë punimit.

Së pari, u realizuan matjet antropometrike, me qëllim vlerësimin e përbërjes trupore dhe parametrave bazë fizikë. Këto përfshinë peshën trupore (kg), gjatësinë trupore (cm), indeksin e masës trupore – BMI (kg/m^2), të llogaritur nga pesha dhe gjatësia, perimetrin e belit (cm), si dhe

SpO₂ (%), që tregon saturimin e oksigjenit në gjak. Këto tregues janë gjerësisht të përdorur në literaturën shkencore për monitorimin e statusit shëndetësor dhe të zhvillimit fizik.

Së dyti, u aplikua Darden Test, një bateri testesh për vlerësimin e forcës, qëndrueshmërisë muskulore, fleksibilitetit dhe kapacitetit funksional. Testet përfshinë: Leg Comparison (forca e gjymtyrëve të poshtme), Wall Squat (qëndrueshmëria izometrike e këmbëve), Negative Chin-Up (forca e pjesës së sipërme të trupit), Negative Push-Ups (forca e gjoksit dhe tricepsit), Trunk Curl (forca abdominale), Breath Hold (kapaciteti respirator), Thigh Stretch (fleksibiliteti i kofshës), Back Arch (fleksibiliteti i shtyllës kurrizore) dhe Skinfold (mm) për vlerësimin e yndyrës nënlëkurore.

Së treti, u realizuan matje laboratorike/funksionale për vlerësimin e kontrollit postural dhe ekuilibrit, duke përfshirë: Balance ROM EO (amplituda e lëvizjes së qendrës së presionit me sy hapur), Balance SemTAN EO (cm²) dhe Balance TAN EO (cm²) (sipërfaqja e luhatjes posturale), si dhe Balance 1L EO (ekuilibri statik me një këmbë, me sy hapur).

Gjatë gjithë punimit janë përdorur emërtimet standarde në gjuhën angleze për testet dhe variablat, me qëllim ruajtjen e saktësisë metodologjike dhe përputhshmërisë me literaturën ndërkombëtare shkencore. Përdorimi i terminologjisë origjinale në anglisht lehtëson krahasimin e rezultateve me studime të tjera, rrit qartësinë akademike dhe garanton uniformitet në raportimin e të dhënave në kontekst ndërkombëtar.

3.2 Testimet e kryera në këtë studim

Matjet Antropometrike

U realizuan për vlerësimin e përbërjes trupore dhe parametrave bazë fizikë:

- Pesha trupore (kg)
- Gjatësia trupore (cm)
- BMI (kg/m²) – i llogaritur nga pesha dhe gjatësia
- Perimetri i belit (cm)
- SpO₂ (%) – saturimi i oksigjenit në gjak

Darden Test (Performanca Fizike)

Bateri testesh për forcë, qëndrueshmëri dhe fleksibilitet:

- Leg Comparison – forcë e gjymtyrëve të poshtme
- Wall Squat – qëndrueshmëri izometrike e këmbëve
- Negative Chin-Up – forcë e pjesës së sipërme të trupit
- Negative Push-Ups – forcë e gjoksit dhe tricepsit
- Trunk Curl – forcë abdominale
- Breath Hold – kapacitet respirator
- Thigh Stretch – fleksibilitet i kofshës
- Back Arch – fleksibilitet i shtyllës kurrizore

- Skinfold (mm) – vlerësim i yndyrës nënlëkurore

Matjet Laboratorike / Funksionale

U përdorën për vlerësimin postural:

- Balance ROM EO – amplituda e lëvizjes së qendrës së presionit (me sy hapur)
- Balance SemTAN EO (cm²) – sipërfaqja e luhatjes postural
- Balance TAN EO (cm²) – sipërfaqja e luhatjes posturale
- Balance 1L EO Ekuilibri statik me një këmbë (sy hapur) – kontrolli postural në qëndrim

3.3 Programi tradicional (grupi kontrollit) 12 javë

Stërvitja tradicionale të grupit të kontrollit: gjoks+ biceps (3 ditë/javë); kardio ngrohjeje 10 minuta, stërvitje force (50-60 minuta), stërvitje shtrirjeje (5 minuta)



Figurë 1 Stërvitja me programin tradicional “gjoks+ biceps”

Stërvitja tradicionale të grupit të kontrollit: Shpinë + triceps (3 ditë/javë); kardio ngrohjeje 10 minuta, forcë (50-60 minuta), shtrirje (5 minuta)



Figurë 2 Stërvitja me programin tradicional “Shpinë + triceps”

Stërvitja tradicionale të grupit të kontrollit: Supet + këmbët (3 ditë/javë); kardio ngrohjeje 10 minuta, stërvitje force (50-60 minuta), stërvitje shtrirjeje (5 minuta)



Figurë 3 Stërvitja me programin tradicional “Supet + këmbët”

3.4 Programi ndërhyrës (grupi ndërhyrës) 12 javë

Qëllimi i programit ndërhyrës është ndarë në 3 module

Moduli 1- java 1-4 (kardio dhe qëndrueshmeri në forcë)

Qëllimi- (kardio + qëndrueshmeri në forcë)

Kohëzgjatja totale 70 min; warm up (10 min) duke përdorur litarin për të përgatitur trupin për ushtrimet, qëndrueshmëri muskulare me vegla (30 Min) me 7 ushtrime 2 sete secila me nga 15 përsëritje (koha e pushimit mes seteve= 30 sek.), kardio (20 min step/ pistë/ biçikletë (përdorim këto pajisje), stretching (10 min) duke përdorur ushtrime për të liruuar muskujt mbas ushtrimeve.

Moduli 2- java 5-8 (forcë dhe hipertrofi)

Qëllimi- Forcë dhe hipertrofi

Java 5 dhe 7 Qëllimi- Forcë

Java 6 dhe 8 Qëllimi- Hipertrofi

Kohëzgjatja totale 70 min; warm up (10 min) step për të përgatitur trupin për ushtrimet, ushtrime force (45 min) duke përdorur 7 ushtrime compaund 3-4 sete nga 6-8 reps (pushimi 2-3 min) dhe stretching (15 min) duke përdorur ushtrime për të liruar muskujt mbas ngarkesës.

Moduli 3- java 9-12 (kardio, ushtrime fleksibiliteti dhe core strength)

Qëllimi- (kardio, ushtrime fleksibiliteti dhe core strength)

Kohëzgjatja totale 70 min; kardio (20 min) ushtrimet janë për të gjithë trupin (core upper, core down), ushtrime funksionale (25 min) dhe ushtrime fleksibiliteti dhe ekuilibri (25 min) ushtrime për të përmirësuar fleksibilitetin dhe ekuilibrin.

3.5 Testimet e kryera- ilustrim

3.5.1 Matjet antropometrike



Figurë 4 Matja e O₂ “Oksimetri”



Figurë 5 Matja: Pesha dhe lartësia trupore



Figurë 6 Matja: Perimetri i belit

3.5.2 Matja/ testimi i ekulibrit sipas protokolleve te platformes Leonardo

Platforma elektronike “Leonardo Mechanography” bën pjesë në grupin e aparaturave mjekësore në laboratorin e UST-së. Përbëhet nga dy platforma me nga 4 (katër) sensorë secila. Softwar-i i saj përmban një protokoll me 17 teste të ndryshëm, nga të cilët përftohen të dhëna të shumta. Moshë e subjekteve që testohen shtrihet nga 3 në 99 vjeç. Shërben jo vetëm për vlerësimin dhe shqyrtimin e kondicionit fizik për subjektet e shëndetshëm dhe ata sportivë, por edhe për qëllime gjeriatrike (në moshën e thellë), për të parandaluar rrezikimin e aktiviteteve bazike si pasojë e moshës.

Testimi ekulibrit me sy hapur dhe mbyllur (Balance Test- ROM EO dhe ROM EC)

Testi i Ekuilibrit/, me një protokoll prej 8 pozicionesh teston aftësinë e Ekuilibrit & Koordinimit

Lëvizja: Subjekti përpiqet që të qëndrojë mundësisht sa më i shtangët për një diapazon të caktuar kohe (p.sh. 10 sekonda). Për të rritur vështirësinë e testit, mund të përzgjidhen pozicione të ndryshme të këmbëve, shoqëruar me sytë hapur ose mbyllur.

Disponohen llojet e mëposhtme standart:

Qëndrimi Romberg, sytë e hapur (Rom EO) (këmbët e puthitura, krahët para)

Qëndrimi Romberg, sytë e mbyllur (Rom EC)



Figurë 7 Matja: Balance Test- ROM EO dhe ROM EC

Testimi i ekulibrit me sy hapur dhe mbyllur (Balance Test- Sem Tan EO dhe Sem Tan EC)

Qëndrimi Semi-Tangent, sytë e hapur (SemTanEO) /gjysma e këmbës përpara, krahët anash/

Qëndrimi Semi-Tangent, sytë e mbyllur (SemTanEC)



Figurë 8 Matja: Balance Test- Sem Tan EO dhe Sem Tan EC

Testimi ekulibrit me sy hapur dhe mbyllur (Balance Test- Tan EO dhe Tan EC)

Qëndrimi Tangent, sytë e hapur (TanEO) krahët anash

Qëndrimi Tangent, sytë e mbyllur



Figurë 9 Matja: Balance Test- Tan EO dhe Tan EC

Testimi ekulibrit në qëndrimin me një këmbë me sy hapur dhe mbyllur (Balance Test- 1L EO dhe 1L EC)

Qëndrimi me një këmbë, sytë e hapur (1L EO) krahët anash

Qëndrimi me një këmbë, sytë e mbyllur (1L EC)



Figurë 10 Matja: Balance Test- Qëndrimi me një këmbë 1L EO dhe 1L EC

3.5.3 Testimet e kryera sipas protokollit Darden

Protokolli Darden (Congres American Catalogue) përmban 10 mini teste standart për përcaktimin e nivelit të fitnesit sipas moshave

Leg Comparison

Qëllimi i këtij testi është të krahasoje muskulin e këmbës së djathtë me muskulin e këmbës së majtë.

Paisjet që kërkohen për këtë test- një metër shirit.

Me ndihmën e partnerit shëno tre pika tek të dy këmbët- një në perimetrin më të gjerë të pulpës dy inch sipër gjurit dhe 9 inch mbi gju. Mati dhe shëno me saktësi deri në 1/16 inch perimetrat e secilës këmbë me këmbët zbathur dhe muskuj të relaksuar.

Shënim:

Këmbët duhet të kenë të njëjtën masë afërsisht. Nëse nuk janë, tregon që këmba më e vogël është dispropocionalisht më e dobët dhe më afër dëmtimit. Krahasojmë tri matjet e këmbës së majtë me atë të djathtë. Përzgjidh diferencën më të madhe dhe gjeji pikët në tabelën e mëposhtme (meshkuj dhe femra):

Më pak se	≤ 3.1 mm	10 pikë
Ndërmjet	3.1 mm- 6.3 mm	8 pikë
Ndërmjet	6.3 mm- 9.3 mm	6 pikë
Ndërmjet	9.3 mm- 12.7 mm	4 pikë
Ndërmjet	12.7 mm- 15.5 mm	2 pikë
Më shumë se	≥ 15.5 mm	0 pikë



Figurë 11 Leg Comparison

Wall Squat

Qëllimi i këtij testi është për të vlerësuar forcën e vitheve e te pjesëve të sipërme të këmbës.

Paisjet- orë me sekonda, jastëk dhe një mur i lëmuar

Hapat qe duhen ndjekur:

1. vendos jastëkun në fund të murit
2. llogarit një pozicion të mbështetur me shpatulla mbi mur dhe me këmbët 12 inch larg murit
3. mbështeti duart për ta stabilizuar trupin tuaj
4. rrëshqit lehtë deri sa kofsha të jetë paralel me tokën
5. kryqëzoji duar në gjoks
6. qëndro në këtë pozicion sa më shumë të jetë e mundur duke kronometruar kohën
7. ndalo kohën kur kofshët nuk janë paralel me tokën

Shënim: ushtrimi forcon vithet dhe kofshët në pikat maksimale të tij.

Më shumë se 60 sek	= 10 pikë
50- 59 sek	= 8 pike
40-49 sek	=6 pikë
30- 39 sek	=4 pikë
20= 29 sek	= 2 pikë
Më pas se 19 sek	= 0 pikë



Figurë 12 Wall squat

Negative Chinup

Mbajtja e “mjekrës”- për forcën e krahëve e muskujt e pasëm të trupit.

Qëllimi- për të vlerësuar forcën e krahëve dhe muskujve të pasëm, lart të trupit

Paisjet- dy karrige, një shkop ose hekur, orë me sekonda

Hapat që duhen ndjekur:

- 1.ndaji karriget me distancë 24 inch (25.4 x 24. 60 cm)
- 2.vendose hekurin mbi karrige dhe ulu direkt nën hekur
3. me duar nga brenda mblidhu duke tërhequr gjoksin drejt hekurit dhe qëndro ashtu
4. mbajti këmbët drejt dhe prek vetëm me thembra
5. qëndro në këtë pozicion sa më shumë të jetë e mundur- duke kronometruar kohën dhe duke rënë gradualisht nga pozicioni i parë deri sa tju drejtohen krahët ose ndonjë pjesë e trupit (vithe këmbë) prek tokën

Meshkuj		Femra	
Më shumë se 60 sek	= 10 pikë	Më shumë se 30 sek	= 10 pikë
50- 59 sek	= 8 pike	25- 29 sek	= 8 pike
49- 49 sek	=6 pikë	20- 24 sek	=6 pikë
30- 39 sek	=4 pikë	15- 19 sek	=4 pikë
20- 29 sek	= 2 pikë	10- 14 sek	= 2 pikë
Më pak se 19 sek	= 0 pikë	Më pak se 19 sek	= 0 pikë



Figurë 13 Negative chinup

Negative Push up

Qëllimi- për të vlerësuar forcën e krahëve, shpatullave dhe gjoksit

Paisjet- vetëm nje orë me sekonda

Hapat që duhen ndjekur:

1. shtrihuni në pozicionin pompa toke, zbathur me gishta të përthyer nga brenda, dhe duart poshtë shpatullave
2. filloni testin kur krahët janë të shtrirë pra lart
3. filloni përthyerjen krahët anash duke ulur trupin
4. mundohuni që gjatë kësaj ulje te mbani pozicionin sa më shumë të jetë e mundur
5. koha mbaron kur gjoksi, trupi ose këmbët prekin tokën.

Meshkuj	Femra
---------	-------

Më shumë se 60 sek	= 10 pikë	Më shumë se 30 sek	= 10 pikë
50- 59 sek	= 8 pike	25- 29 sek	= 8 pike
49- 49 sek	=6 pikë	20- 24 sek	=6 pikë
30- 39 sek	=4 pikë	15- 19 sek	=4 pikë
20- 29 sek	= 2 pikë	10- 14 sek	= 2 pikë
Më pak se 19 sek	= 0 pikë	Më pak se 19 sek	= 0 pikë



Figurë 14 Negative push up

Trunk Curl

Përkulja e trungut (shtrirë)

Qëllimi- për të vlerësuar forcën në mesin e trupit

Paisjet- një orë me sekonda, një libër të trashë 5 cm

Hapat që duhen ndjekur:

1. shtrihuni me shpinë me duart e mbledhura në gjoks
2. përkuluni para dhe hapni gjunjët
3. përpquni të përkuleni drejt pozicionit ulur me vetëm 1/3 të të ulurit dhe
4. qëndroni në pozicion kontraktimi
5. ndërkohë që lëshoheni shtrirë- me ndihmën e një kolegu vendosni librin 5 cm midis tokës dhe pjesës së poshtme
- Mos e lejo kurrizin të prekë librin, qëndro ashtu sa më shumë të jetë e mundur
6. mbani kohën kur kurrizi prek dyshejenë.

Më shumë se 60 sek	= 10 pikë
50- 59 sek	= 8 pike
49- 49 sek	=6 pikë
30- 39 sek	=4 pikë
20- 29 sek	= 2 pikë
Më pak se 19 sek	= 0 pikë



Figurë 15 Trunk curl

Breath Holding

Mbajtja e frymës

Qëllimi- për të vlerësuar qëndrueshmërinë e zembrës dhe mushkërive

Paisjet- vetëm një orë me sekonda

Hapat që duhen ndjekur:

1. vraponi për 90 sek duke ngritur secilën këmbë 10 cm nga toka
2. ndaloni së vrapuari mbas 90 sek
3. merrni frymë thellë tri herë
4. mbajeni frymarrjen e fundit sa më shumë të jetë e mundur duke regjistruar kohën

Më shumë se 30 sek	= 10 pikë
25- 29 sek	= 8 pike

20- 24 sek	=6 pikë
15- 19 sek	=4 pikë
10- 14 sek	= 2 pikë
Më pak se 9 sek	= 0 pikë



Figurë 16 Breath holding

Thigh stretch Strecing

Qëllimi: për të vlerësuar fleksibilitetin e pjesës së pasme të këmbëve

Paisjet- nje vizore 30 cm

Hapat që duhen ndjekur:

1. hiqini këpucët dhe uluni në dysheme. Këmbët qëndrojnë të hapura 15 cm duke takuar vetëm në tokë
2. vendoseni vizoren midis këmbëve duke filluar nga thembrat, 2.2 cm qëndron hapësira midis krahëve dhe gjunjëve
3. kur përkulim tringun, duhet të mbajmë këmbët e shtrira dhe nuk duhet të lëvizim mbi dysheme. Më ndihmën e partnerit shënoni pikën më të largët të përkuljes tuaj

Më shumë se 25 cm	= 10 pikë
Ndërmjet 20- 22.5 cm	= 8 pike
Ndërmjet 15- 17.5 cm	=6 pikë
Ndërmjet 10- 12.5 cm	=4 pikë
Ndërmjet 5- 7.5 cm	= 2 pikë
Më pak se 2.5 cm	= 0 pikë



Figurë 17 Thigh stretch Strecing

Back Arch

Harkim prapa


Qëllimi- për të vlerësuar fleksibilitetin e shpinës

Paisjet- ndihmës partner dhe vizore

Hapat që duhen ndjekur:

1. rrini përmbysur mbi dysheme
2. mbajini këmbët nga një partner
3. harkojeni trupin duke mbajtur duart mbas qafe dhe duke ngritur mjekrën sa më lart të jetë e mundur
4. partneri të masë distancën nga mjekra në tokë.

Më shumë se 45 cm	= 10 pikë
Ndërmjet 40- 42.5 cm	= 8 pike
Ndërmjet 35- 37.5 cm	=6 pikë
Ndërmjet 30- 32.5 cm	=4 pikë
Ndërmjet 25- 27.5 cm	= 2 pikë
Më pak se 22.5 cm	= 0 pikë



Figurë 18 Back arch

Skinfold Pinc (Testi i palosjes dhjimore)

Qëllimi- për të vlerësuar dhjamin trupor

Paisjet- një vizore e thjeshtë

Hapat që duhen ndjekur:

1. sic do hap që kemi marrë duhet një partner për të tërhequr palën e dhjimit dhe për ta matur atë
2. lokalizojmë zonën e matjes në triceps në mes midis shpatullës dhe brrylit (nga e djathta) duke e lënë krahun të varur
3. pickojmë lehtë vertikalisht ndërmjet dy gishtave (të madh dhe tregues), tërhiqeni dhjamin nga krahu duke siguruar që nuk tërhiqni muskulin vetëm lëkurë dhe dhjam
4. përdorni vizoren duke matur midis dy gishtave pjesën e dhjimit e të lëkurës duke niveluar majën e dhjimit të zgjedhur me thonjtë. Mos e shtypni vizoren kundrejt dhjimit sepse e bëni të duket me i trashë se në të vërtetë
5. merrni dy matje të ndryshme e pastaj nxirrni mesataren e tyre
6. siç u veprua në triceps të veprohet dhe në zonën e kërthizës por me kapje horizontale
7. nxirrni mesataren e dy vlerave pra një mesatare e kombinuar

Më pak se 1.5 cm	= 10 pikë
2.5 cm	= 8 pike
3 cm	=6 pikë
3.7 cm	=4 pikë
4 cm	= 2 pikë
Më shumë se 4 cm	= 0 pikë



Figurë 19 Skinfold pinc matja1



Figurë 20 Skinfold pinc matja 2

Arm Comparison (Krahasimi në dy gjendje i krahut)

Qëllimi: për të vlerësuar muskulin në trup

Pajisjet- një metër shirit i thjeshtë

Hapat që duhen ndjekur:

1. sic do hap që kemi marrë duhet një partner për matjen
2. relaksojeni krahun poshtë dhe mateni atë në mes shpatullës dhe brrylit
3. ngrijeni krahun paralel me tokën duke kontraktuar fort bicepsin dhe mateni perimetrin me të madh
4. merrni diferencën midis dy matjeve

Shënim: Te një person muskuloz ka një diferencë dramatike ndërmjet dy matjeve ndërsa tek personat e dhjamosur kemi një diferencë të vogël.

Më shumë se 3.7 cm	= 10 pikë
3 cm	= 8 pike
2.5 cm	=6 pikë
1.8 cm	=4 pikë
1.3 cm	= 2 pikë
Më pak se 1.3 cm	= 0 pikë



Figurë 21 Arm Comparison

3.6 Analiza statistikore e të dhënave

Analiza statistikore u realizua duke përdorur një Mixed ANOVA me masa të përsëritura, me qëllim vlerësimin e efektit të programit stërvitor 12-javor në ndryshimet e performancës fizike të pjesëmarrësve. Në këtë studim, faktori brenda-subjektit (within-subjects factor) përfaqësohej nga koha, e cila kishte dy nivele matjeje: para ndërhyrjes (Pre) dhe pas ndërhyrjes (Post). Faktori midis-subjekteve (between-subjects factor) ishte grupi, i ndarë në dy kategori: grupi eksperimental, i cili iu nënshtrua programit stërvitor, dhe grupi kontroll, i cili vazhdoi rutinën e tij të zakonshme pa ndërhyrje shtesë.

Analiza u krye në programin SPSS (v.26), duke përdorur procedurën standarde: *Analyze- General Linear Model- Repeated Measures*, ku u definua faktori kohë dhe u specifikuan variablat përkatëse të matjeve. Për të siguruar një interpretim të plotë të rezultateve, u aktivizuan statistikat

përshkruese (descriptive statistics), madhësitë e efektit (partial eta squared), si dhe testet e homogjenitetit të variancave (Levene's Test), të cilat ndihmojnë në verifikimin e supozimeve të nevojshme për vlefshmërinë e analizës. Gjithashtu u gjeneruan grafikët e ndërveprimit për të vizualizuar trendin e ndryshimeve midis dy grupeve nga Pre në Post.

Efekti kryesor i interesit në këtë analizë ishte ndërveprimi *Time* × *Group*, i cili vlerëson nëse ndryshimi nga Pre në Post është i ndryshëm midis grupit eksperimental dhe atij kontroll. Ky ndërveprim është treguesi kryesor në studimet me ndërhyrje, pasi tregon nëse programi stërvitor ka prodhuar një efekt specifik që nuk mund t'i atribuohet vetëm kalimit të kohës ose diferencave ekzistente midis grupeve. Një ndërveprim domethënës do të sugjeronte se pjesëmarrësit e grupit eksperimental kanë përfituar ndjeshëm më shumë nga programi 12-javor sesa pjesëmarrësit e grupit kontroll.

Kreu IV- Rezultatet

4.1 Matjet antropometrike

Tabela 1 paraqet vlerat mesatare dhe devijimin standard të peshës trupore te meshkujt të ndara sipas grupit të ndërhyrjes dhe grupit të kontrollit, para (pre) dhe pas (post) periudhës së studimit. Në matjen para ndërhyrjes (Body_Weight_pre), grupi i ndërhyrjes shfaq një peshë mesatare prej 91.18 ± 11.51 kg, ndërsa grupi i kontrollit 87.54 ± 10.26 kg. Vlera mesatare totale për të dy grupet është 89.36 ± 10.88 kg, çka tregon një nivel fillestar relativisht të krahasueshëm të peshës trupore, me peshë disi më të lartë në grupin e ndërhyrjes. Në matjen pas ndërhyrjes (Body_Weight_post), vërehet një ulje e lehtë e peshës mesatare në grupin e ndërhyrjes, e cila zbret në 89.26 ± 10.57 kg, duke sugjeruar një tendencë pozitive drejt reduktimit të peshës trupore. Nga ana tjetër, grupi i kontrollit paraqet një ndryshim minimal, me vlerë mesatare 87.06 ± 9.02 kg. Mesatarja totale pas ndërhyrjes është 88.16 ± 9.73 kg.

Tabelë 1 Vlerat mesatare dhe devijimi standard i peshës trupore (kg) tek meshkujt sipas grupit (ndërhyrje dhe kontroll) para dhe pas periudhës së studimit

Group		Mean	Std. Deviation
Body_Weight_pre	Intervention	91.175	11.5134
	Control	87.538	10.2582
	Total	89.356	10.8846
Body_Weight_post	Intervention	89.2563	10.56636
	Control	87.0625	9.01679
	Total	88.1594	9.72651

Tabela 2 paraqet vlerat mesatare dhe devijimin standard të peshës trupore te femrat, të ndara sipas grupit të ndërhyrjes dhe grupit të kontrollit, para (pre) dhe pas (post) periudhës së studimit. Në matjen para ndërhyrjes (Body_Weight_pre), grupi i ndërhyrjes paraqet një peshë mesatare prej 70.68 ± 8.88 kg, ndërsa grupi i kontrollit 66.75 ± 9.86 kg. Mesatarja totale për të dy grupet është 68.71 ± 9.45 kg, duke treguar se femrat në grupin e ndërhyrjes kishin në fillim një peshë mesatare disi më të lartë krahasuar me grupin e kontrollit. Në matjen pas ndërhyrjes (Body_Weight_post), vërehet një ulje e qartë e peshës mesatare në grupin e ndërhyrjes, e cila zbret në 68.74 ± 7.77 kg, duke reflektuar një ndryshim pozitiv pas aplikimit të ndërhyrjes. Ndërkohë, grupi i kontrollit shfaq një ndryshim shumë të vogël, me peshë mesatare 66.29 ± 10.34 kg. Mesatarja totale pas ndërhyrjes është 67.51 ± 9.08 kg.

Tabelë 2 Vlerat mesatare dhe devijimi standard i peshës trupore (kg) tek femrat sipas grupit (ndërhyrje dhe kontroll) para dhe pas periudhës së studimit

Group		Mean	Std. Deviation
Body_Weight_pre	Intervention	70.682	8.8803
	Control	66.747	9.8628
	Total	68.714	9.4458
Body_Weight_post	Intervention	68.7375	7.76598
	Control	66.2875	10.33576
	Total	67.5125	9.07868

Rezultatet ne tabelen 3 tregojnë se efekti i kohës (Time) është statistikisht i rëndësishëm ($F = 5.718$, $p = 0.023$, Partial Eta Squared = 0.160), duke nënkuptuar se peshat trupore të meshkujve kanë ndryshuar ndjeshëm nga matja pre në post, pavarësisht grupit. Ndërkohë, ndërveprimi Time \times Group nuk rezulton statistikisht i rëndësishëm ($p = 0.160$, Partial Eta Squared = 0.065), çka tregon se ndryshimi i peshës trupore nuk ka qenë dukshëm i ndryshëm midis grupit të ndërhyrjes dhe atij të kontrollit.

Tabelë 3 Rezultatet e analizës multivariate (MANOVA) për efektin e kohës dhe ndërveprimin Kohë \times Grup në peshën trupore të meshkujve (pre–post)

Effect		Value	F	Sig.	Partial Eta Squared
Time	Pillai's Trace	0.160	5.718 ^c	0.023	0.160
	Wilks' Lambda	0.840	5.718 ^c	0.023	0.160
	Hotelling's Trace	0.191	5.718 ^c	0.023	0.160
	Roy's Largest Root	0.191	5.718 ^c	0.023	0.160
Time * Group	Pillai's Trace	0.065	2.080 ^c	0.160	0.065
	Wilks' Lambda	0.935	2.080 ^c	0.160	0.065
	Hotelling's Trace	0.069	2.080 ^c	0.160	0.065
	Roy's Largest Root	0.069	2.080 ^c	0.160	0.065

Rezultatet ne tabelen 4 tregojnë se efekti i kohës (Time) është shumë statistikisht i rëndësishëm ($F = 13.156$, $p = 0.001$), me madhësi të madhe efekti (Partial Eta Squared = 0.305), duke treguar se peshat trupore të femrave kanë ndryshuar ndjeshëm nga matja pre në post. Ndërkohë, ndërveprimi Time \times Group rezulton gjithashtu statistikisht i rëndësishëm ($F = 5.021$, $p = 0.033$, Partial Eta

Squared = 0.143), çka tregon se ndryshimi i peshës trupore me kalimin e kohës ka qenë i ndryshëm midis grupit të ndërhyrjes dhe atij të kontrollit.

Tabelë 4 Rezultatet e analizës multivariate (MANOVA) për efektin e kohës dhe ndërveprimin Kohë × Grup në peshën trupore të femrave (pre–post)

Effect		Value	F	Sig.	Partial Eta Squared
Time	Pillai's Trace	0.305	13.156 ^c	0.001	0.305
	Wilks' Lambda	0.695	13.156 ^c	0.001	0.305
	Hotelling's Trace	0.439	13.156 ^c	0.001	0.305
	Roy's Largest Root	0.439	13.156 ^c	0.001	0.305
Time * Group	Pillai's Trace	0.143	5.021 ^c	0.033	0.143
	Wilks' Lambda	0.857	5.021 ^c	0.033	0.143
	Hotelling's Trace	0.167	5.021 ^c	0.033	0.143
	Roy's Largest Root	0.167	5.021 ^c	0.033	0.143

Rezultatet ne tabelen 5 tregojnë se efekti i kohës (Time) është statistikisht i rëndësishëm ($F = 5.718$, $p = 0.023$), me madhësi mesatare efekti (Partial Eta Squared = 0.160), duke treguar se peshat trupore të meshkujve kanë ndryshuar ndjeshëm nga matja pre në post. Ndërkohë, ndërveprimi Time × Group nuk rezulton statistikisht i rëndësishëm ($F = 2.080$, $p = 0.160$, Partial Eta Squared = 0.065), çka tregon se ndryshimi i peshës trupore me kalimin e kohës nuk ka qenë i ndryshëm midis grupit të ndërhyrjes dhe atij të kontrollit.

Tabelë 5 ANOVA me masa të përsëritura për peshën trupore të meshkujve (efekti i Kohës dhe Kohë × Grup)

Source		Mean Square	F	Sig.	Partial Eta Squared
Time	Sphericity Assumed	22.920	5.718	0.023	0.160
	Greenhouse-Geisser	22.920	5.718	0.023	0.160
	Huynh-Feldt	22.920	5.718	0.023	0.160
	Lower-bound	22.920	5.718	0.023	0.160
Time * Group	Sphericity Assumed	8.338	2.080	0.160	0.065
	Greenhouse-Geisser	8.338	2.080	0.160	0.065
	Huynh-Feldt	8.338	2.080	0.160	0.065
	Lower-bound	8.338	2.080	0.160	0.065
Error (Time)	Sphericity Assumed	4.009			
	Greenhouse-Geisser	4.009			

Huynh-Feldt	4.009
Lower-bound	4.009

Rezultatet ne tabelen 6 tregojnë se efekti i kohës (Time) është shumë statistikisht i rëndësishëm ($F = 13.156$, $p = 0.001$), me madhësi të madhe efekti (Partial Eta Squared = 0.305), duke treguar se peshat trupore të femrave kanë ndryshuar ndjeshëm nga matja pre në post. Gjithashtu, ndërveprimi Time \times Group rezulton statistikisht i rëndësishëm ($F = 5.021$, $p = 0.033$), me madhësi mesatare efekti (Partial Eta Squared = 0.143), çka tregon se ndryshimi i peshës trupore me kalimin e kohës ka qenë i ndryshëm midis grupit të ndërhyrjes dhe atij të kontrollit.

Tabelë 6 ANOVA me masa të përsëritura për peshën trupore të femrave (efekti i Kohës dhe Kohë \times Grup)

Measure:	MEASURE_1				
Source		Mean Square	F	Sig.	Partial Eta Squared
Time	Sphericity Assumed	23.112	13.156	0.001	0.305
	Greenhouse-Geisser	23.112	13.156	0.001	0.305
	Huynh-Feldt	23.112	13.156	0.001	0.305
	Lower-bound	23.112	13.156	0.001	0.305
Time * Group	Sphericity Assumed	8.821	5.021	0.033	0.143
	Greenhouse-Geisser	8.821	5.021	0.033	0.143
	Huynh-Feldt	8.821	5.021	0.033	0.143
	Lower-bound	8.821	5.021	0.033	0.143
Error (Time)	Sphericity Assumed	1.757			
	Greenhouse-Geisser	1.757			
	Huynh-Feldt	1.757			
	Lower-bound	1.757			

Rezultatet e kontrasteve lineare tregojnë se efekti i kohës (Time) është statistikisht i rëndësishëm ($F = 5.718$, $p = 0.023$), me madhësi mesatare efekti (Partial Eta Squared = 0.160), duke treguar se peshat trupore të meshkujve kanë ndryshuar ndjeshëm nga matja pre në post (tabela 7). Ndërkohë, ndërveprimi linear Time \times Group nuk rezulton statistikisht i rëndësishëm ($F = 2.080$, $p = 0.160$, Partial Eta Squared = 0.065), çka tregon se ndryshimi i peshës trupore me kalimin e kohës nuk ka qenë i ndryshëm midis grupit të ndërhyrjes dhe atij të kontrollit.

Tabelë 7 Rezultatet e kontrasteve lineare për efektin e Kohës dhe ndërveprimin Kohë × Grup në peshën trupore të meshkujve (pre–post)

Source		Mean Square	F	Sig.	Partial Eta Squared
Time	Linear	22.920	5.718	0.023	0.160
Time * Group	Linear	8.338	2.080	0.160	0.065
Error (Time)	Linear	4.009			

Rezultatet e kontrasteve lineare tregojnë se efekti i kohës (Time) është shumë statistikisht i rëndësishëm ($F = 13.156$, $p = 0.001$), me madhësi të madhe efekti (Partial Eta Squared = 0.305), duke treguar se peshat trupore të femrave kanë ndryshuar ndjeshëm nga matja pre në post (tabela 8). Gjithashtu, ndërveprimi linear Time × Group rezulton statistikisht i rëndësishëm ($F = 5.021$, $p = 0.033$), me madhësi mesatare efekti (Partial Eta Squared = 0.143), çka tregon se ndryshimi i peshës trupore me kalimin e kohës ka qenë i ndryshëm midis grupit të ndërhyrjes dhe atij të kontrollit.

Tabelë 8 Rezultatet e kontrasteve lineare për efektin e Kohës dhe ndërveprimin Kohë × Grup në peshën trupore të femrave (pre–post)

Measure:	MEASURE_1				
Source		Mean Square	F	Sig.	Partial Eta Squared
Time	Linear	23.112	13.156	0.001	0.305
Time * Group	Linear	8.821	5.021	0.033	0.143
Error (Time)	Linear	1.757			

Rezultatet e analizës së efekteve ndër-subjekte (tabela 9) tregojnë se Intercept është shumë statistikisht i rëndësishëm ($F = 2385.432$, $p < 0.001$), me madhësi shumë të madhe efekti (Partial Eta Squared = 0.988), çka është e pritshme dhe pasqyron nivelin mesatar të përgjithshëm të peshës trupore të meshkujt. Nga ana tjetër, efekti i grupit (Group) nuk rezulton statistikisht i rëndësishëm ($F = 0.644$, $p = 0.429$), me madhësi të vogël efekti (Partial Eta Squared = 0.021). Kjo tregon se nuk ka dallime domethënëse në peshën mesatare trupore midis grupit të ndërhyrjes dhe atij të kontrollit të meshkujt, kur merret parasysh mesatarja e përgjithshme.

Tabelë 9 Rezultatet e analizës së efekteve ndër-subjekte për peshën trupore të meshkujve sipas grupit

Measure:	MEASURE_1				
Transformed Variable:	Average				

Source	Mean Square	F	Sig.	Partial Eta Squared
Intercept	504188.754	2385.432	0.000	0.988
Group	136.014	0.644	0.429	0.021
Error	211.362			

Rezultatet e analizës së efekteve ndër-subjekte tregojnë se Intercept është shumë statistikisht i rëndësishëm ($F = 1747.850$, $p < 0.001$), me madhësi shumë të madhe efekti (Partial Eta Squared = 0.983), duke reflektuar nivelin mesatar të përgjithshëm të peshës trupore te femrat (tabela 10). Nga ana tjetër, efekti i grupit (Group) nuk rezulton statistikisht i rëndësishëm ($F = 0.960$, $p = 0.335$), me madhësi të vogël efekti (Partial Eta Squared = 0.031). Kjo tregon se nuk ka dallime domethënëse në peshën mesatare trupore midis grupit të ndërhyrjes dhe atij të kontrollit te femrat, kur merret parasysh mesatarja e përgjithshme.

Tabelë 10 Rezultatet e analizës së efekteve ndër-subjekte për peshën trupore të femrave sipas grupit

Measure:	MEASURE_1			
Transformed Variable:	Average			
Source	Mean Square	F	Sig.	Partial Eta Squared
Intercept	296924.184	1747.850	0.000	0.983
Group	163.073	0.960	0.335	0.031
Error	169.880			

Tabela 11 paraqet vlerat mesatare dhe devijimin standard të Indeksit të Masës Trupore (BMI) te meshkujt, të ndara sipas grupit të ndërhyrjes dhe grupit të kontrollit, para (pre) dhe pas (post) periudhës së studimit. Në matjen para ndërhyrjes (BMI_pre), grupi i ndërhyrjes paraqet një BMI mesatar prej 26.85 ± 1.82 , ndërsa grupi i kontrollit 26.50 ± 4.02 . Mesatarja totale është 26.66 ± 3.06 , duke treguar se të dy grupet ndodheshin në intervalin e mbipeshës, me vlera fillestare relativisht të krahasueshme. Në matjen pas ndërhyrjes (BMI_post), vërehet një ulje e qartë e BMI-së në grupin e ndërhyrjes, i cili zbrit në 25.93 ± 1.58 , duke reflektuar një përmirësim drejt vlerave më të favorshme shëndetësore. Në të kundërt, grupi i kontrollit shfaq një rritje të BMI-së, duke arritur në 27.64 ± 2.10 . Mesatarja totale pas ndërhyrjes është 26.88 ± 1.99 .

Tabelë 11 Vlerat mesatare dhe devijimi standard i BMI tek meshkujt sipas grupit (ndërhyrje dhe kontroll) para dhe pas periudhës së studimit

Group		Mean	Std. Deviation
BMI_pre	Intervention	26.850	1.8212
	Control	26.500	4.0218
	Total	26.656	3.0603
BMI_post	Intervention	25.9250	1.58403
	Control	27.6400	2.10071
	Total	26.8778	1.99109

Tabela 12 paraqet vlerat mesatare dhe devijimin standard të Indeksit të Masës Trupore (BMI) te femrat, të ndara sipas grupit të ndërhyrjes dhe grupit të kontrollit, para (pre) dhe pas (post) periudhës së studimit. Në matjen para ndërhyrjes (BMI_pre), grupi i ndërhyrjes paraqet një BMI mesatar prej 30.48 ± 15.72 , ndërsa grupi i kontrollit 24.40 ± 3.17 . Mesatarja totale është 27.44 ± 11.57 , duke treguar një variabilitet shumë të lartë të BMI-së te femrat, veçanërisht në grupin e ndërhyrjes, me vlera që shtrihen nga mbipesha deri në obezitet. Në matjen pas ndërhyrjes (BMI_post), vërehet një ulje e BMI-së në grupin e ndërhyrjes, i cili zbret në 28.79 ± 15.81 , duke sugjeruar një përmirësim të përgjithshëm pas ndërhyrjes. Grupi i kontrollit shfaq një ndryshim minimal, me BMI mesatar 24.09 ± 3.02 . Mesatarja totale pas ndërhyrjes është 26.44 ± 11.45 .

Tabelë 12 Vlerat mesatare dhe devijimi standard i BMI tek femrat sipas grupit (ndërhyrje dhe kontroll) para dhe pas periudhës së studimit

Group		Mean	Std. Deviation
BMI_pre	Intervention	30.475	15.7208
	Control	24.400	3.1673
	Total	27.438	11.5742
BMI_post	Intervention	28.7938	15.81326
	Control	24.0938	3.02313
	Total	26.4438	11.45073

Rezultatet tregojnë se efekti i kohës (Time) nuk është statistikisht i rëndësishëm ($F = 0.015$, $p = 0.907$), me madhësi shumë të vogël efekti (Partial Eta Squared = 0.002), duke treguar se BMI i meshkujve nuk ka ndryshuar ndjeshëm nga matja pre në post, në tërësi (tabela 13). Gjithashtu, ndërveprimi Time \times Group nuk rezulton statistikisht i rëndësishëm ($F = 1.368$, $p = 0.280$). Edhe pse Partial Eta Squared = 0.163 sugjeron një madhësi të moderuar efekti, mungesa e rëndësisë

statistikore tregon se ndryshimet e BMI-së me kalimin e kohës nuk kanë qenë dukshëm të ndryshme midis grupit të ndërhyrjes dhe atij të kontrollit.

Tabelë 13 Rezultatet e analizës multivariate (MANOVA) për efektin e kohës dhe ndërveprimin Kohë × Grup në BMI të meshkujve (pre–post)

Effect		Value	F	Sig.	Partial Eta Squared
Time	Pillai's Trace	0.002	.015 ^c	0.907	0.002
	Wilks' Lambda	0.998	.015 ^c	0.907	0.002
	Hotelling's Trace	0.002	.015 ^c	0.907	0.002
	Roy's Largest Root	0.002	.015 ^c	0.907	0.002
Time * Group	Pillai's Trace	0.163	1.368 ^c	0.280	0.163
	Wilks' Lambda	0.837	1.368 ^c	0.280	0.163
	Hotelling's Trace	0.195	1.368 ^c	0.280	0.163
	Roy's Largest Root	0.195	1.368 ^c	0.280	0.163

Rezultatet tabela 14 tregojnë se efekti i kohës (Time) është shumë statistikisht i rëndësishëm ($F = 18.368$, $p < 0.001$), me madhësi të madhe efekti (Partial Eta Squared = 0.380), duke treguar se BMI i femrave ka ndryshuar ndjeshëm nga matja pre në post. Gjithashtu, ndërveprimi Time × Group rezulton statistikisht i rëndësishëm ($F = 8.791$, $p = 0.006$), me madhësi mesatare–të madhe efekti (Partial Eta Squared = 0.227), çka tregon se ndryshimi i BMI-së me kalimin e kohës ka qenë i ndryshëm midis grupit të ndërhyrjes dhe atij të kontrollit.

Tabelë 14 Rezultatet e analizës multivariate (MANOVA) për efektin e kohës dhe ndërveprimin Kohë × Grup në BMI të femrave (pre–post)

Effect		Value	F	Sig.	Partial Eta Squared
Time	Pillai's Trace	0.380	18.368 ^c	0.000	0.380
	Wilks' Lambda	0.620	18.368 ^c	0.000	0.380
	Hotelling's Trace	0.612	18.368 ^c	0.000	0.380
	Roy's Largest Root	0.612	18.368 ^c	0.000	0.380

Time * Group	Pillai's Trace	0.227	8.791 ^c	0.006	0.227
	Wilks' Lambda	0.773	8.791 ^c	0.006	0.227
	Hotelling's Trace	0.293	8.791 ^c	0.006	0.227
	Roy's Largest Root	0.293	8.791 ^c	0.006	0.227

Rezultatet tregojnë se efekti i kohës (Time) nuk është statistikisht i rëndësishëm ($F = 0.015$, $p = 0.907$), me madhësi shumë të vogël efekti (Partial Eta Squared = 0.002), duke treguar se BMI i meshkujve nuk ka ndryshuar ndjeshëm nga matja pre në post (tabela 15). Gjithashtu, ndërveprimi Time \times Group nuk rezulton statistikisht i rëndësishëm ($F = 1.368$, $p = 0.280$). Megjithëse Partial Eta Squared = 0.163 sugjeron një efekt të moderuar, mungesa e rëndësisë statistikore tregon se ndryshimet e BMI-së me kalimin e kohës nuk kanë qenë dukshëm të ndryshme midis grupit të ndërhyrjes dhe atij të kontrollit.

Tabelë 15 ANOVA me masa të përsëritura për BMI të meshkujve (efekti i Kohës dhe Kohë \times Grup)

Measure:		MEASURE_1			
Source		Mean Square	F	Sig.	Partial Eta Squared
Time	Sphericity Assumed	0.051	0.015	0.907	0.002
	Greenhouse-Geisser	0.051	0.015	0.907	0.002
	Huynh-Feldt	0.051	0.015	0.907	0.002
	Lower-bound	0.051	0.015	0.907	0.002
Time * Group	Sphericity Assumed	4.738	1.368	0.280	0.163
	Greenhouse-Geisser	4.738	1.368	0.280	0.163
	Huynh-Feldt	4.738	1.368	0.280	0.163
	Lower-bound	4.738	1.368	0.280	0.163
Error (Time)	Sphericity Assumed	3.464			
	Greenhouse-Geisser	3.464			
	Huynh-Feldt	3.464			
	Lower-bound	3.464			

Rezultatet ne tabelen 16 tregojnë se efekti i kohës (Time) është shumë statistikisht i rëndësishëm ($F = 18.368$, $p < 0.001$), me madhësi të madhe efekti (Partial Eta Squared = 0.380), duke treguar se BMI i femrave ka ndryshuar ndjeshëm nga matja pre në post. Gjithashtu, ndërveprimi Time \times

Group rezulton statistikisht i rëndësishëm ($F = 8.791$, $p = 0.006$), me madhësi mesatare-të madhe efekti (Partial Eta Squared = 0.227), çka tregon se ndryshimi i BMI-së me kalimin e kohës ka qenë i ndryshëm midis grupit të ndërhyrjes dhe atij të kontrollit.

Tabelë 16 ANOVA me masa të përsëritura për BMI të femrave (efekti i Kohës dhe Kohë × Grup)

Measure:		MEASURE_1			
Source		Mean Square	F	Sig.	Partial Eta Squared
Time	Sphericity Assumed	15.801	18.368	0.000	0.380
	Greenhouse-Geisser	15.801	18.368	0.000	0.380
	Huynh-Feldt	15.801	18.368	0.000	0.380
	Lower-bound	15.801	18.368	0.000	0.380
Time * Group	Sphericity Assumed	7.562	8.791	0.006	0.227
	Greenhouse-Geisser	7.562	8.791	0.006	0.227
	Huynh-Feldt	7.562	8.791	0.006	0.227
	Lower-bound	7.562	8.791	0.006	0.227
Error (Time)	Sphericity Assumed	0.860			
	Greenhouse-Geisser	0.860			
	Huynh-Feldt	0.860			
	Lower-bound	0.860			

Rezultatet e kontrasteve lineare tregojnë se efekti i kohës (Time) nuk është statistikisht i rëndësishëm ($F = 0.015$, $p = 0.907$), me madhësi shumë të vogël efekti (Partial Eta Squared = 0.002), duke treguar se BMI i meshkujve nuk ka ndryshuar ndjeshëm nga matja pre në post (tabela 17). Gjithashtu, ndërveprimi linear Time × Grup nuk rezulton statistikisht i rëndësishëm ($F = 1.368$, $p = 0.280$). Edhe pse Partial Eta Squared = 0.163 sugjeron një efekt të moderuar, mungesa e rëndësisë statistikore tregon se ndryshimet e BMI-së me kalimin e kohës nuk kanë qenë dukshëm të ndryshme midis grupit të ndërhyrjes dhe atij të kontrollit.

Tabelë 17 Rezultatet e kontrasteve lineare për efektin e Kohës dhe ndërveprimin Kohë × Grup në BMI të meshkujve (pre-post)

Measure:		MEASURE_1			
Source		Mean Square	F	Sig.	Partial Eta Squared
Time	Linear	0.051	0.015	0.907	0.002

Time * Group	Linear	4.738	1.368	0.280	0.163
Error (Time)	Linear	3.464			

Rezultatet e kontrasteve lineare tregojnë se efekti i kohës (Time) është shumë statistikisht i rëndësishëm ($F = 18.368$, $p < 0.001$), me madhësi të madhe efekti (Partial Eta Squared = 0.380), duke treguar se BMI i femrave ka ndryshuar ndjeshëm nga matja pre në post (tabela 18). Gjithashtu, ndërveprimi linear Time \times Group rezulton statistikisht i rëndësishëm ($F = 8.791$, $p = 0.006$), me madhësi mesatare-të madhe efekti (Partial Eta Squared = 0.227), çka tregon se ndryshimi i BMI-së me kalimin e kohës ka qenë i ndryshëm midis grupit të ndërhyrjes dhe atij të kontrollit.

Tabelë 18 Rezultatet e kontrasteve lineare për efektin e Kohës dhe ndërveprimin Kohë \times Grup në BMI të femrave (pre-post)

Measure:		MEASURE_1			
Source		Mean Square	F	Sig.	Partial Eta Squared
Time	Linear	15.801	18.368	0.000	0.380
Time * Group	Linear	7.562	8.791	0.006	0.227
Error (Time)	Linear	0.860			

Rezultatet ne tabelen 19 e analizës së efekteve ndër-subjekte tregojnë se Intercept është shumë statistikisht i rëndësishëm ($F = 1176.325$, $p < 0.001$), me madhësi jashtëzakonisht të madhe efekti (Partial Eta Squared = 0.994), çka pasqyron nivelin mesatar të përgjithshëm të BMI-së te meshkujt. Në të kundërt, efekti i grupit (Group) nuk rezulton statistikisht i rëndësishëm ($F = 0.192$, $p = 0.675$), me madhësi shumë të vogël efekti (Partial Eta Squared = 0.027). Kjo tregon se nuk ka dallime domethënëse në BMI-në mesatare midis grupit të ndërhyrjes dhe atij të kontrollit te meshkujt, kur merret parasysh mesatarja e përgjithshme.

Tabelë 19 Rezultatet e analizës së efekteve ndër-subjekte për BMI të meshkujve sipas grupit

Measure:		MEASURE_1			
Transformed Variable:		Average			
Source		Mean Square	F	Sig.	Partial Eta Squared
Intercept		12700.908	1176.325	0.000	0.994

Group	2.070	0.192	0.675	0.027
Error	10.797			

Rezultatet e analizës së efekteve ndër-subjekte tregojnë se Intercept është statistikisht shumë i rëndësishëm ($F = 180.514$, $p < 0.001$), me madhësi të madhe efekti (Partial Eta Squared = 0.857), duke reflektuar nivelin mesatar të përgjithshëm të BMI-së të femrat (tabela 20). Nga ana tjetër, efekti i grupit (Group) nuk rezulton statistikisht i rëndësishëm ($F = 1.805$, $p = 0.189$), me madhësi të vogël-mesatare efekti (Partial Eta Squared = 0.057). Kjo tregon se nuk ka dallime domethënëse në BMI-në mesatare midis grupit të ndërhyrjes dhe atij të kontrollit të femrat, kur merret parasysh mesatarja e përgjithshme.

Tabelë 20 Rezultatet e analizës së efekteve ndër-subjekte për BMI të femrave sipas grupit

Measure:	MEASURE_1			
Transformed Variable:	Average			
Source	Mean Square	F	Sig.	Partial Eta Squared
Intercept	46451.026	180.514	0.000	0.857
Group	464.402	1.805	0.189	0.057
Error	257.326			

Tabela 21 paraqet vlerat mesatare dhe devijimin standard të perimetrit të belit të meshkujt, të ndara sipas grupit të ndërhyrjes dhe grupit të kontrollit, para (pre) dhe pas (post) periudhës së studimit. Në matjen para ndërhyrjes (Waist_pre), grupi i ndërhyrjes paraqet një perimetër mesatar të belit prej 96.00 ± 3.16 cm, ndërsa grupi i kontrollit 101.20 ± 9.93 cm. Mesatarja totale është 98.89 ± 7.79 cm, duke treguar se grupi i kontrollit kishte vlera fillestare më të larta dhe variabilitet më të madh. Në matjen pas ndërhyrjes (Waist_post), vërehet një ulje e qartë e perimetrit të belit në grupin e ndërhyrjes, i cili zbret në 92.00 ± 2.94 cm, duke reflektuar një përmirësim të dukshëm pas ndërhyrjes. Ndërkohë, grupi i kontrollit shfaq një ulje shumë të vogël, duke arritur në 100.20 ± 5.72 cm. Mesatarja totale pas ndërhyrjes është 96.56 ± 6.19 cm.

Tabelë 21 Vlerat mesatare dhe devijimi standard i perimetrit të belit tek meshkujt sipas grupit (ndërhyrje dhe kontroll) para dhe pas periudhës së studimit

Group	Mean	Std. Deviation
-------	------	----------------

